



Македонско здружение на млади правници

**Situata e azilit në Republikën e  
Maqedonisë së Veriut  
Viti 2020**

**Shkupi, 2021**



Македонско здружение на млади правници

Titulli i origjinalit:

Состојбата на азилот во Република Северна Македонија 2020 година

Ботон: Shoqata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë

Redaktore: Bojana Bozhinovska Siljanovska

Autorë: Teodora Qoseva Kostadinovska

Igor Stojčevski

Përkthyer nga maqedonishtja

Përkthyes: Valon Abdiu

Dizajni dhe redaktimi grafik: Daniel Stanoeski

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

341.43(497.7)"2020"(047.31)

314.151.3-054.7"2020"(047.31)

QOSEVA Kostadinovska, Teodora

Situata e azilit në Republikën e Maqedonisë së Veriut Viti 2020

[Електронски извор] / [autorë Teodora Qoseva Kostadinovska, Igor Stojčevski ; përkthyer nga maqedonishtja përkthyes Valon Abdiu]. -

Shkupi : Shokata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë, 2021

Начин на пристапување (URL): <http://www.myla.org.mk/>. - Превод на делото: Состојбата на азилот во Република Северна Македонија 2020 година. - Текст во PDF формат, содржи 47 стр. - Наслов преземен од екранот. - Опис на изворот на ден 16.11.2021. - Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4843-52-8

1. Stojčevski, Igor [автор]

а) Систем на азил -- Македонија -- 2020 -- Истражувања

COBISS.MK-ID 55515909



Përmbajtja	
Lista e shkurtesave .....	5
Hyrje .....	7
Pasqyrë e shkurtër e situatës në vend .....	8
Qasja në territor dhe parimi i moskthimit .....	10
Qasja në procedurë .....	12
Procedura e azilit .....	14
Procedura administrative .....	14
Procedura para gjykatave administrative .....	20
Qendrat e pranimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut .....	22
Kushtet në qendrat e pranimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut .....	24
QT Vinojug .....	26
QT Tabanoc .....	28
QP për azilkërkuesit .....	29
Mbajtja për arsye emigrimi .....	30
Integrimi .....	32
Integrimi i hershëm .....	32
Integrimi i refugjatëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut .....	35
Integrimi i refugjatëve nga kriza e Kosovës e vitit 1999 në Republikën e Maqedonisë së Veriut .....	37
E drejta për natyralizim .....	38
E drejta për mbrojtje sociale .....	39
Kategoritë e cënueshme .....	40
Fëmijët .....	40
Dhuna seksuale dhe ajo me bazë gjinore .....	43
Rekomandime .....	45

## **Lista e shkurtesave**

Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR)

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)

Bashkimi Evropian (BE)

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ)

Numri unik amë i qytetarit (NUAQ)

Ligji për Azilin dhe Mbrojtjen e Përkohshme (LAMP)

Ligji për Mbrojtjen Ndërkombëtare dhe të Përkohshme (LMNP)

Ligji për Ndhmën Juridike Falas (LNJF)

Ligji për Shtetësinë (LSh)

Ligjit për Procedurën Penale (LPP)

Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative (LPPA)

Ligji për Kontestet Administrative (LKA)

Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM)

Shoqata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë (ShJRM)

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale (MPPS)

Ministria e Punëve të Brendshme (MPB)

Mekanizmi Parandalues Kombëtar (MPK)

I mitur i pashoqëruar - fëmijë i huaj (MPFH)

Qendra e Pranimit për Azilkërkuesit - Vizbeg (Qendra e Pranimit)

Qendra e Transitit (QT)

Republika e Maqedonisë së Veriut (RMV)

Romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët (RAE)

Spektori i Azilit (Spektori)

Qendra për Punë Sociale (QPS)

Qendra për Menaxhim me Krizat (QMK)

Ky raport paraqet një pasqyrë gjithëpërfshirëse të praktikave, politikave dhe procedurave të ndryshme që lidhen me sistemin e azilit në Republikën e Maqedonisë së Veriut në vitin 2020. Raporti i potencon sfidat kryesore me të cilat përballen azilkërkuesit dhe refugjatët gjatë procedurës së azilit dhe gjatë ushtrimit të të drejtave të tjera. Gjatë përgatitjes së këtij dokumenti u përdorën: a) të dhënat e marra gjatë përfaqësimit të azilkërkuesve, refugjatëve dhe emigrantëve, personave nën mbrojtje plotësuese (subsidiare) dhe refugjatëve të njohur në Republikën e Maqedonisë së Veriut, b) të dhënat e marra gjatë monitorimit të situatës dhe veprimit nga ana e autoriteteve me refugjatët dhe emigrantët në qendrat e transitit, ku ShJRM ka zyra në dispozicion, dhe c) të dhënat e marra gjatë prezencës në zyrë në Qendrën e Pranimet për Azilkërkuesit në Shkup. Për më tepër, për qëllimet e këtij raporti, u siguruan informata me karakter publik dhe u përdorën raporte dhe literaturë e shumtë që ishin në dispozicion.

Ky publikim mbështetet nga Zyra e Përfaqësisë së UNHCR-së në Shkup. Mendimet dhe qëndrimet e shprehura në këtë publikim janë mendime të autorit dhe nuk i pasqyrojnë domosdoshmërisht qëndrimet zyrtare të UNHCR -së.



## HYRJE

Shoqata e Juristëve të Rinj të Maqedonisë (në tekstin e mëtejme ShJRM), e mbështetur nga Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët në Shkup (në tekstin e mëtejme: UNHCR), është duke e zbatuar në vazhdimësi projektin për përfaqësim dhe ofrim të ndihmës juridike falas për azilkërkuesit dhe personat nën mbrojtje ndërkombëtare në procedurat para organeve shtetërore dhe gjyqësore të vendit. ShJRM-ja punon me sukses për më shumë se njëmbëdhjetë vjet në mbrojtjen e të drejtave të këtyre personave, duke u kujdesur për realizimin e tyre të plotë dhe duke marrë pjesë rregullisht në zbatimin e procedurave të azilit, të garantuara në përputhje me aktet ligjore të vlefshme në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Në punën e saj, ShJRM-ja i përfaqëson azilkërkuesit që vijnë nga vendet e rajonit dhe jashtë tij, e të cilët aplikojnë për azil në Republikën e Maqedonisë së Veriut (RMV). ShJRM-ja jep këshilla juridike për të parashtruar kërkesë për azil dhe për procedurën para se të parashtrohet kërkesa, për të gjithë të huajt që synojnë të parashtrojnë kërkesë. Pas hapjes së Qendrave e Transitit (QT), edhe atë në jug - Qendra e Transitit "Vinojug", kurse në veri - Qendra e Transitit "Tabanoc", ShJRM-ja ka një prani të përditshme me hapësirat e saj në këto qendra, ku e monitoron situatën, jep këshilla dhe informacion fillestar mbi procedurën e azilit, siguron mbështetje dhe udhëzime dhe ndërmjetëson për personat që dëshirojnë të parashtrojnë kërkesë në procedurën para organeve kompetente. ShJRM-ja gjithashtu ka zyrë edhe në Qendrën e Pranimit të Azilkërkuesve në Shkup, ku me prezencën e saj të përditshme i përfaqëson azilkërkuesit, ofron këshilla dhe konsultime juridike, kujdeset dhe ndërmjetëson për çështje që lidhen me të drejtat e tyre që u takojnë atyre si azilkërkues dhe procedurat në lidhje me statusin e tyre. ShJRM-ja gjithashtu ofron këshilla juridike dhe i përfaqëson personat nën mbrojtje ndërkombëtare në të gjitha procedurat para organeve shtetërore. Përveç kësaj, në kuadër të punës së saj, ShJRM-ja i përfaqëson edhe refugjatët nga kriza e Kosovës e vitit 1999, të cilët janë ende në vend dhe gëzojnë mbrojtje ndërkombëtare, dhe ofron ndihmë juridike në procedurat që lidhen me statusin e tyre dhe të drejtat që u takojnë.

Në përputhje me përvojën dhe praktikën në ofrimin e ndihmës juridike falas për azilkërkuesit dhe personat nën mbrojtje ndërkombëtare në vend, ShJRM-ja e përgatiti këtë raport i cili ofron një analizë gjithëpërfshirëse të qasjes në procedurën e azilit, vetë procedurës së azilit dhe të veprimeve të organeve kompetente, të procedurës për integrim dhe (mos)respektimit të të drejtave të personave të prekur. Për më tepër, ky raport i tregon edhe mangësitë në zbatimin e ligjeve dhe akteve nënligjore të vendit në fushën e azilit, si dhe të dokumenteve ndërkombëtare të miratuara në përputhje me Kushtetutën e RMV-së. Përmes një prezantimi të këtillë, ne përpiqemi të krijojmë një sistem efikas për azil dhe integrimin e personave nën mbrojtje ndërkombëtare, në të cilin të drejtat e tyre të garantuara do të respektohen në masën të madhe. Në këtë dokument janë paraqitur shembuj realë, të dhëna që janë në dispozicion dhe rekomandime për tejkalimin e dobësive dhe problemeve të caktuara në sistemin e azilit në RMV.

## PASQYRË E SHKURTËR E SITUATËS NË VEND

Maqedonia është një nga pikat qendrore për transit nëpër Rrugën ballkanike, drejt destinacioneve të dëshiruara përfundimtare.

Duke e përjetuar RMV-në si një vend transit, e jo si destinacion përfundimtar, koha mesatare e qëndrimit të refugjatëve në qendrat e transimit është disa ditë. Mirëpo, në vitin 2020, ndryshimi kryesor që ndikoi në disa procese ishte shfaqja e pandemisë së KOVID-19.

Shfaqja e virusit e përkeqësoi ndjeshëm situatën për emigrantët dhe azilkërkuesit që erdhën në RMV në periudhën e kaluar nga disa aspekte. Presidenti i RMV-së shpalli gjendjen e jashtëzakonshme më 18 mars të vitit 2020 në të gjithë territorin e vendit<sup>1</sup> dhe ajo zgjati deri më 23 qershor 2020, me një ndërprerje të caktuar. Pandemia kontribuoi në shfaqjen e mangësive dhe vështirësive në zbatimin e procedurës së azilit dhe procedurave në lidhje me ushtrimin e së drejtës për mbrojtje ndërkombëtare, duke i respektuar njëkohësisht rekomandimet për parandalimin dhe mbrojtjen nga virusi. Kjo ndikoi edhe në lëvizjen e parregullt të emigrantëve nëpër territorin e RMV-së dhe aftësinë e shtetit për t'i kontrolluar këto lëvizje në një kohë kur vazhdimisht merreshin masa parandaluese për t'u mbrojtur nga përhapja e virusit. Për shkak të kësaj, shteti zbatoi disa ndryshime dhe miratoi masa në lidhje me emigrantët dhe azilkërkuesit.

Në seancën e Qeverisë, u miratua përfundimi se "Në periudhën e gjendjes së jashtëzakonshme të shpallur për shkak të shfaqjes së virusit KOVID-19, të gjithë azilkërkuesit e rinj, si dhe personat e sapo gjetur me qëndrim të parregulluar në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, fillimisht në periudhë prej 25 ditëve të vendosen në karantinë në Qendrën e Transimit në Vinojug - Gjevgjeli".<sup>2</sup> Pas përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme, kjo praktikë vazhdoi, dhe pasi u parashtruan ankesa në raste individuale dhe pas reagimit të ShJRM-së dhe UNHCR-së për këtë çështje, ky afat u reduktua në karantinë 14-ditore, me qëllim që të eliminohet diskriminimi i kësaj kategorie të personave nga qytetarët ose shtetasit e huaj të tjerë.

Që nga fillimi i pandemisë, regjistrimi i emigrantëve në QT "Vinojug" është pezulluar, dhe kjo qendër, përveç azilkërkuesve, është bërë një qendër karantine edhe për personat e mbajtur si dëshmitarë në procedurat penale kundër kontrabandistëve.

Qendra e Pranimit të Azilkërkuesve në Vizbeg (Qendra e Pranimit) mbeti qendra e vetme në të cilën vendosen të gjithë azilkërkuesit dhe ajo është në kompetencë të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale (MPPS). Si përjashtim, është paraparë mundësia që fëmijët e pashoqëruar të vendosen në familje kujdestare dhe akomodim individual privat duke i mbuluar vetë shpenzimet e tyre me miratimin paraprak të MPPS-së. Pas përfundimit të akomodimit në karantinë në QT "Vinojug", aplikuesit u shoqëruan dhe u vendosën në Qendrën e Pranimit.

<sup>1</sup> <https://pretsedatel.mk/%d0%b2%d0%be%d0%bd%d1%80%d0%b5%d0%b4%d0%bd%d0%be-%d0%be%d0%b1%d1%80%d0%b0%d1%9c%d0%b0%d1%9a%d0%b5-%d0%bd%d0%b0-%d0%bf%d1%80%d0%b5%d1%82%d1%81%d0%b5%d0%b4%d0%b0%d1%82%d0%b5%d0%bb%d0%be%d1%82-%d0%bd/>

<sup>2</sup> Fragment nga propozim-procesverbali i seancës së njëzet e tetë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, të mbajtur më 25 mars 2020.



Megjithatë, sistemi i mbrojtjes së fëmijëve, veçanërisht për sa i përket akomodimit, mbeti jofunksional në lidhje me fëmijët emigrantë dhe azilkërkuesit që janë pa prindër ose pa kujdes prindëror. Sipas Ligjit për Mbrojtjen Sociale,<sup>3</sup> përveç familjeve kujdestare, duhet të merret parasysh edhe akomodimi në njësi të veçanta banimi, në institucione të veçanta ose forma të tjera të mbrojtjes. Kjo veçanërisht për fëmijët më të mëdhenj, të cilët janë në numër të madh, por ata gjithmonë akomodohen në qendrat e transitit me të gjithë emigrantët dhe azilkërkuesit e tjerë, kurse disa nga këto qendra kanë kushte që korrespondojnë me paraburgimin. Prandaj, është e nevojshme që menjëherë të gjenden alternativa dhe të funksionojë sistemi dhe mekanizmat që janë në dispozicion për mbrojtjen e fëmijëve. Në këtë mënyrë do të shmangej praktika e mbajtjes së tyre në kushte të papërshtatshme dhe do të respektohej parimi i njohur ndërkombëtarisht se asnjë fëmijë nuk duhet të mbahet/paraburgoset për arsye emigrimi.

Në vitin 2020, zbatimi i Ligjit për Ndhmën Juridike Falas në pjesën e ndihmës juridike falas për azilkërkuesit që duhet të ofrohet nga shteti ende nuk është realizuar në praktikë.

Edhe pse pandemia globale ka bërë dhe ka imponuar ndryshime në situatën e azilit në vend, megjithatë kjo nuk i mbulon mangësitë e sistemit dhe një pjesë të problemeve që kanë vazhduar ndër vite. ShJRM-ja vuri në dukje dhe raportoi disa nga këto probleme, të tilla si mohimi i të drejtës për të parashtruar kërkesë për njohjen e së drejtës për azil për një pjesë të refugjatëve, kthimi i detyruar i azilkërkuesve në territorin e Greqisë, nevoja për ta përmirësuar procedurën për përcaktimin e statusit të refugjatit, aktvendime të paarsyetuara si duhet, pa i kushtuar vëmendje të mjaftueshme kësaj dhe vlerësimi i nevojës për mbrojtje ndërkombëtare. Risia kryesore dhe një hap pozitiv ishte fillimi i mbajtjes së shqyrtimit me gojë në përputhje me Ligjin e ri për Kontestet Administrative<sup>4</sup> para Gjykatës Administrative në RMV.

Për arsyet e mësipërme, përmes këtij raporti përpiqemi të inkurajojmë institucionet që t'i sigurojnë të drejtat themelore të garantuara dhe masat mbrojtëse të procesit dhe ato materiale të refugjatëve në RMV.

---

<sup>3</sup> Ligji për Mbrojtjen Sociale ("Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 104 e datës 23.05.2019).

<sup>4</sup> Ligji për Kontestet Administrative ("Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr. 96 e datës 17.05.2019).



## HYRJA NË TERRITORIN E VENDIT DHE PARIMI I MOSKTHIMIT

Parimi i moskthimit, i njohur si non-refoulement, është një nga postulatet bazë, si në të drejtën ndërkombëtare,<sup>5</sup> ashtë edhe në të drejtën e vendit<sup>6</sup> në lidhje me trajtimin e refugjatëve dhe azilkërkuesve. Ky parim i mbron personat me status të refugjatit, por edhe të gjithë ata të cilëve ky status ende nuk u është njohur zyrtarisht.


Sipas këtij parimi, i cili është pranuar dhe është futur në sistemin ligjor të RMV-së, nga shtetet kërkohet të sigurojnë dhe të garantojnë qasje në territorin e saj dhe procedurë efikase të azilit për personat të cilët për arsye të caktuara janë gjetur në territorin e saj dhe kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare. Ky parim i ndalon shtetet t'i kthejnë këta persona në një vend ku ekziston rreziku i persekutimit duke përdorur çfarëdo forme të largimit të detyruar, duke përfshirë deportimin, dëbimin, ekstradimin, transferimin joformal dhe refuzimin e pranimit në kufi. Me këtë rast, ai është detyruar dhe i ndalon plotësisht shtetet që ta shkelin, të heqin dorë, ta përjashtojnë ose ta kufizojnë atë.

---

<sup>5</sup> Neni 33 i Konventës së Kombeve të Bashkuara lidhur me Statusin e Refugjatëve të vitit 1951. Konventa mund të gjendet në ueb-faqen e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatët: <https://www.unhcr.org/3b66c2aa10>.

<sup>6</sup> Neni 14 i LMNP-së.

Në vitin 2020, pavarësisht pandemisë globale, numri i njerëzve të kapur dhe të kthyer në ndonjërin nga vendet fqinje shënon një rritje të vogël në krahasim me vitin 2019. Në vitin 2020, ShJRM-ja regjistroi 29.706 raste të kthimit jashtë procedurës formale, për dallim nga viti 2019, kur numri i kthimeve të këtilla ishte 20.511.



Kjo praktikë ka vazhduar ndër vite dhe vazhdon edhe sot e kësaj dite, ndërsa numri i personave të kthyer pa e zbatuar dhe pa e respektuar procedurën formale ligjore rritet nga viti në vit. Për më tepër, gjatë pandemisë, për shkak të mosregjistrimit, të gjithë emigrantët e kapur në kufirin jugor u kthyen në mënyrë joformale në Greqi, pa e bërë regjistrimin e tyre dhe pa e zbatuar procedurën për vlerësimin individual të nevojave të tyre. Megjithatë, përveç personave të kapur në kufirin jugor, gjatë vitit është vënë re një trend i personave që u kapën në afërsi të kufirit verior, e të cilët më pas u shoqëruan deri në territorin e Greqisë jashtë procedurës formale. Për më tepër, policia herë pas here i transportonte personat e vendosur në QT Tabanoc deri në kufirin me Greqinë, ku ata liheshin në disa pika jozyrtare. Shumica e këtyre njerëzve shprehën qëllimin e tyre për t'u kthyer në Greqi, por disa prej tyre, pa bërë vlerësim të gjendjes së tyre dhe kundër vullnetit të tyre, u transportuan së bashku me të tjerët në një grup. Personat fillimisht u regjistruan me të dhënat e tyre zyrtare në QT Tabanoc, por një pjesë e vogël e tyre u transportuan pa u regjistruar fare.

Nga grupi i personave të kapur në territorin e RMV-së, një pjesë e vogël u dërguan në Qendrën e Pranimit për të Huajt si dëshmitarë në procedurat penale kundër kontrabandistëve, dhe pas dhënies së dëshmisë, ata u lejuan të largoheshin nga qendra. Mirëpo, **pjesa më e madhe e këtyre kategorive të personave si dëshmitarë në procedurat penale gjatë vitit 2020 u mbajtën në QT Vinojug, edhe pse në asnjë rast nuk u mor vendim për mbajtjen e tyre.** Sipas aktvendimit në bazë të kërkesës së parashtruar për informata me karakter publik<sup>7</sup> është theksuar se janë parandaluar 32.100 përpjekje për kalim ilegal të kufirit shtetëror me vendet fqinje, kurse në hyrje të RMV-së janë parandaluar gjithsej 26.309 persona.

<sup>7</sup> Aktvendimi nr. 16.12-208/1 për t'iu përgjigjur kërkesës për qasje të lirë në informatën e kërkuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e RMV-së.

Në vitin 2020, ShJRM-ja ndërhyri në 25 raste të ndryshme në mënyrë që të respektohet parimi i moskthimit nga ana e autoriteteve kompetente. Nevoja për ta respektuar këtë parim iu theksua edhe Sektorit të Azilit gjatë kryerjes së intervistave zyrtare me azilkërkuesit.

Të gjithë personat që kanë hyrë në territorin e RMV-së, dhe me të cilët juristë në terren të ShJRM-së kanë zhvilluar bisedë, deklaruan se nuk ishin të informuar nga policia dhe organet e tjera për mundësinë për të parashtruar kërkesë për azil në vend. Disa prej tyre, me shpjegimin se kishin hyrë në vend ilegalisht dhe pa bërë vlerësim individual të rastit, policia i ka kthyer në mënyrë të palejuar në Greqi, pavarësisht faktit se në vend ka ende refugjatë që vijnë nga zonat ku zhvillohet luftë dhe të cilët kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare. Edhe pse shumë prej emigrantëve u gjetën dhe u kapën në territorin e RMV-së, shteti i trajton këto raste si parandalim i hyrjes ilegale në territorin e tij.


#### • QASJA NË PROCEDURË

LMNP-ja e rregullon në detaje procedurën për një të huaj i cili mund të parashtrorë kërkesë për njohjen e së drejtës për azil në RMV. Me këtë rast, këta persona mund ta bëjnë këtë në vendkalimin kufitar, në stacionin më të afërt të policisë, në Qendrën e Pranimit për të Huajt ose në Sektorin e Azilit. Nëpunësi i policisë do ta evidentojë kërkesën dhe do ta bëjë regjistrimin dhe më pas është i detyruar për këtë ta informojë Sektorin e Azilit dhe aplikuesin ta dërgojë në Qendrën e Pranimit. Në vitin 2020, azilkërkuesit, pas kërkesës së parashtruar, u vendosën në karantinë në QT Vinojug, në përputhje me vendimin e Qeverisë së RMV-së. Pas përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme, pas reagimit nga ShJRM-ja dhe UNHCR-ja, dhe ankesave të parashtruara kundër vendimeve për akomodim, MPPS-ja përcaktoi se azilkërkuesit do të vendoseshin në karantinë 14-ditore. Përjashtim bëhej vetëm nëse kërkuesi ka test negativ PCR, jo më të vjetër se 48 orë. Në atë rast, ai duhet të transferohet menjëherë në Qendrën e Pranimit. Mirëpo, edhe vendimi i korigjuar për karantinën 14-ditore nuk ka bazë në ligj ose në ndonjë akt tjetër, që përsëri e vë në pikëpyetje bazën ligjore për mbajtje në karantinë në një situatë kur kjo masë nuk zbatohet për asnjë kategori tjetër personash në vend. Për më tepër, LMNP-ja përcakton se kushdo që dëshiron të kërkojë azil dhe qëndron në territorin e RMV-së, parashtron kërkesë për njohjen e së drejtës për azil te Sektori. Megjithatë, sipas interpretimit të Sektorit të Azilit, kjo nuk vlen për personat që tashmë kanë qenë azilkërkues në vend dhe të cilët pas përfundimit të procedurës duan të parashtrorë kërkesë të re për azil, por vetëm për të huajt me qëndrim të rregulluar sipas Ligjit për të Huajt. Nëse bëhet fjalë për rast të bashkimit familjar, kërkesa parashtrorë në përfaqësinë diplomatike-konsullore të RMV-së jashtë vendit. Me parashtrimin e kërkesës për njohjen e së drejtës për azil, fillon zyrtarisht procedura e azilit.

Edhe pse asnjë qëllim për të parashtruar kërkesë për azil nuk u regjistrua zyrtarisht në vitin 2020, gjatë kësaj periudhe pati raste në të cilat personat me gojë shprehën qëllimin e tyre për të parashtruar kërkesë për azil, por kjo nuk u regjistrua dhe ata u kthyen në Greqi kundër vullnetit të tyre.

Në gusht të vitit 2020, e drejta për qasje në procedurën e azilit iu kufizua një grupi prej 14 refugjatësh nga Afganistani, gjegjësisht tre familjeve, duke përfshirë edhe tetë fëmijë në këtë grup, dhe ata u kthyen me forcë në territorin e Greqisë, megjithëse shprehën qëllimin e tyre për të parashtruar kërkesë për azil. Këta persona para juristit në terren të ShJRM-së dhe nëpunësit të policisë në QT Tabanoc e shprehën qëllimin e tyre për të parashtruar kërkesë për njohjen e së drejtës për azil. Megjithatë, me shpjegimin nga autoritetet kompetente për të mos e ngarkuar procedurën me dokumentacion dhe se personat gjithsesi do të akomodohen në QT Vinojug, këta persona u dërguan për akomodim në QT Vinojug, ku edhe do të mund ta parashtronin kërkesën e tyre. Ata u nisën për në Qendrën e Pranimet me një automjet të policisë, por nuk u akomoduan kurrë atje dhe kërkesat e tyre për azil nuk u regjistruan. Personat në mënyrë eksplicite deklaruan se nuk donin të ktheheshin në Greqi, por kur ShJRM-ja i kontaktoi të gjitha institucionet kompetente për vendndodhjen e këtyre personave, përgjigjja ishte se ata kurrë nuk kishin shprehur qëllimin e tyre për të parashtruar kërkesë për azil dhe pas transportit të tyre në QT Vinojug, ata u larguan nga vendi vullnetarisht.

#### Sipas statistikave të SHMJR:



Në vitin 2020, u vërejt edhe një rast i kthimit ilegal të një azilkërkuesi në territorin e Greqisë, pa lejen dhe pa pëlqimin e tij. MPPS-ja kishte marrë vendim për akomodimin e azilkërkuesit në QT Vinojug, por ai kurrë nuk u vendos në atë qendër, por u kthye në Greqi. ShJRM-ja reagoi menjëherë për këtë rast tek institucionet kompetente. Mirëpo, organet shtetërore theksojnë se azilkërkuesi u largua vetë dhe shprehu qëllimin e tij për t'u kthyer në Greqi. Azilkërkuesi më pas e kontaktoi ShJRM-në dhe konfirmoi se pa pëlqimin e tij, pavarësisht se ishte azilkërkues, ishte kthyer në Greqi jashtë procedurës zyrtare, dhe gjatë rrugës, pasi kishte kaluar kufirin, kishte pësuar lëndime serioze fizike nga një sulm i kryer nga persona me uniformë.<sup>8</sup>

Parashtrimi i kërkesës për personat që ishin mbajtur si dëshmitarë u bë i mundur pasi të kishte kaluar periudha e akomodimit në karantinë dhe pasi personat të kishin dhënë dëshmi para prokurorit publik në procedurën kundër kontrabandistëve. Në disa raste, u vërejt një vonesë e panevojshme e përpunimit të kërkesës për njohjen e së drejtës për azil dhe një vonesë në procesin e transportit deri në Qendrën e Pranimet. Arsyeja kryesore për vonesën në procesin e transportit ishte nevoja për të siguruar një automjet për transferimin e personave, megjithëse disa nga azilkërkuesit u vendosën në karantinë edhe më gjatë se sa që është paraparë për këto arsye.

<sup>8</sup> Më shumë rreth kësaj mund të shihet edhe në Raportin vjetor mbi efikasitetin e mbrojtjes ligjore të të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë së Veriut - viti 2020, fq. 49.




## **PROCEDURA E AZILIT**

### **• PROCEDURA ADMINISTRATIVE**

Procedura e azilit në RMV fillon me parashtrimin e kërkesës për azil. Kërkesa mund të parashtrohet me shkrim ose me gojë në procesverbal, në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik ose,

nëse kjo nuk është e mundur, në gjuhën e vendit të origjinës, në një nga gjuhët e huaja të pranuar gjerësisht ose në një gjuhë që në mënyrë të arsyeshme mund të supozohet se e kupton azilkërkuesi.<sup>9</sup> Organi kompetent për zhvillimin e procedurës së azilit është Sektori i Azilit në MPB. Procedura është administrative dhe në një shkallë, që do të thotë se kur merret vendimi nga Sektori, nuk lejohet ankesë, por aplikuesi ka të drejtë të parashtojë padi në Gjykatën Administrative të RMV-së.<sup>10</sup> Ligji që e rregullon këtë çështje dhe sipas të cilit zhvillohen procedurat e azilit është Ligji për Mbrojtjen Ndërkombëtare dhe të Përkohshme.




Procedura e azilit mund të jetë e rregullt dhe urgjente. Procedura e rregullt zhvillohet në afat prej gjashtë muajve me mundësinë e zgjatjes së këtij afati edhe për tre muaj të tjerë për arsye të justifikuar, por jo më gjatë se nëntë muaj.<sup>11</sup> Pas marrjes së vendimit nga Sektori, mund të ngrihet padi në Gjykatën Administrative në afat prej 30 ditësh nga marrja e vendimit. Procedura urgjente kryhet në afat prej 15 ditëve nga dita e parashtrimit të kërkesës për azil. **Në vitin 2020, nuk u zhvillua asnjë procedurë urgjente në bazë të kërkesës së parashtruar për njohjen e së drejtës për azil.**

<sup>9</sup> Neni 28, paragrafi 1 i LMNP-së.


<sup>10</sup> Neni 43, paragrafi 1 i LMNP-së.

<sup>11</sup> Kjo mundësi është një risi në LMNP - neni 38, paragrafët 2, 3, 4 dhe 5, që nuk ishte parashikuar me Ligjin e vjetër për Azilin. Në fakt, Sektori është i detyruar ta informojë azilkërkuesin për zgjatjen e afatit, dhe në bazë të kërkesës së tij duhet ta informojë atë për arsyet e zgjatjes.

### Numri i azilkërkuesve sipas vendeve të parashtrimit së kërkesave për azil sipas statistikave të SHMJR



### Gjinia dhe moshja e azilkerkuesve



Gjatë vitit, me shfaqjen e koronavirusit, ishte e qartë shtyrja e zhvillimit të intervistave me Sektorin e Azilit, sepse duhej kohë për ta organizuar teknikisht procesin dhe për të gjetur zgjidhje për kryerjen e intervistave, duke i respektuar në të njëjtën kohë masat kufizuese në vend. ShJRM-ja bëri 11 ndërhyrje në raste individuale në mënyrë që të gjente mënyrë dhe modalitete për zhvillimin e tyre, të shoqëruara me rekomandimet e Komisionit Evropian<sup>12</sup> për kapërcimin e problemeve që i solli virusi për sa i përket zbatimit në kohë të procedurave të azilit dhe të drejtave të aplikuesve. Duke filluar nga shtatori, pas rregullimit të dhomave me xham mbrojtës në Qendrën e Pranimit nga ana e ShJRM-së, filloi mbajtja e intervistave online me azilkerkuesit. Që atëherë, intervistat janë zhvilluar pa probleme dhe është respektuar afati ligjor gjashtëmuor për të vendosur për kërkesën e parashtruar për azil.

Vitet e fundit, azilkerkuesve iu është mundësuar kontakt i drejtpërdrejtë me përfaqësuesit e Sektorit të Azilit, edhe atë çdo të mërkurë në Qendrën e Pranimit. Megjithatë, në vitin 2020 ditët e pranimit në qendër nuk u mbajtën për shkak të koronavirusit. Mirëpo, për të siguruar ushtrimin e papenguar të të drejtave të aplikuesve për sa i përket lëshimit të akteve dhe dokumenteve, lëshimit dhe vazhdimin të dokumenteve të identifikimit dhe komunikimit tjetër, ShJRM-ja çdo të mërkurë i vizitonte hapësirat e Sektorit të Azilit dhe i merrte dokumentet e nevojshme për aplikuesit, dhe më pas ua dorëzonte ato në Qendrën e Pranimit, ku ishin të vendosur shumica e tyre.

<sup>12</sup> COMMUNICATION FROM THE COMMISSION COVID-19: Guidance on the implementation of relevant EU provisions in the area of asylum and return procedures and on resettlement (2020/C 126/02), [https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52020XC0417\(07\)&from=EN](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:52020XC0417(07)&from=EN).



Në procedurën e azilit, zhvillohet një intervistë me azilkërkuesin me qëllim që të përcaktohet nëse personit duhet t'i jepet mbrojtje në vend. Sektori i cakton dhe i zhvillon bisedat në përputhje me afatin ligjor, gjegjësisht i kushton vëmendje afatit brenda të cilit duhet të merret vendimi, d.t.th. i zhvillon ato në periudhën nga 15 ditë deri në 6 muaj, me përjashtim të intervistave që nuk u zhvilluan në kohë për shkak të shfaqjes së koronavirusit. Për më tepër, në fillim të vitit u shfaq një problem për shkak të mungesës së përkthyesit nga gjuhët urdu dhe pashtu dhe për këtë arsye tre intervista u shtynë derisa të gjendeshin përkthyes të përshtatshëm nga ana e ShJRM-së në mënyrë që procedura e azilit të zhvillohej pa probleme. Këto intervista u zhvilluan pasi kaluan më shumë se katër muaj. Përveç kësaj, shërbimet e përkthimit zakonisht mbulohen nga ana e UNHCR-së dhe angazhohen nga ShJRM-ja.

Gjatë bisedës me azilkërkuesit, përveç personave zyrtarë të autorizuar, mund të jenë të pranishëm edhe përfaqësuesit e azilkërkuesve (përveç nëse ata nuk vendosin ndryshe), prindi ose kujdestari, nëse i është caktuar azilkërkuesit, një përkthyes në gjuhën që e kuptojnë dhe një përfaqësues i UNHCR-së. Deri më tani, në të gjitha intervistat e zhvilluara në Sektorin e Azilit ka qenë i pranishëm një përfaqësues i ShJRM-së në intervistat në të cilat aplikuesit ishin të përfaqësuar nga ShJRM-ja.

Përkundër parashtrimit të rregullt të fjalës përfundimtare me shkrim pas intervistës së zhvilluar, ato rrallë merren parasysh, kurse provat shpesh nuk shqyrtohen, gjë që mund të konkludohet edhe nga numri i vendimeve negative të marra në procedurat e azilit. **Në vitin 2020, u realizuan gjithsej 45 intervista me azilkërkuesit në Sektorin e Azilit. Koha mesatare nga zhvillimi i intervistës deri në marrjen e vendimit është 115 ditë.**

**Në vitin 2020, vetëm dy fëmijëve të pashoqëruar nga Afganistani iu dha statusi i personit nën mbrojtjes shtesë (subsidiare). Mirëpo, nga ana tjetër, nuk u pranua statusi i refugjatit për asnjë azilkërkues, si formë më gjithëpërfshirëse e mbrojtjes ndërkombëtare<sup>13</sup> (statusi i fundit i njohur i refugjatit u dha në vitin 2016).** Kështu, duke marrë parasysh numrin e personave të intervistuar, mund të konkludohet se shkalla e njohjes së azilit në RMV është 0,9%. Përqindja e ulët e azilkërkuesve që ishin të pranishëm gjatë procedurës së azilit dhe fakti që shumë prej tyre u larguan nga vendi edhe para se të caktohej intervista, bëri që procedura e azilit të ndërpritet nga ana e Sektorit, dhe ky është një faktor që luan një rol të rëndësishëm në përcaktimin e përqindjes së kërkesave të pranuar për azil.

**Në vitin 2020, ShJRM-ja mori 40 vendime negative (25 prej tyre për refugjatët nga kriza e Kosovës e vitit 1999 dhe 15 për azilkërkuesit e rinj). Në të njëjtën kohë, Sektori i Azilit mori 63 vendime për të ndërprerë procedurën për azilkërkuesit e rinj.**

Vendimet me të cilat refuzohen kërkesat për njohjen e të drejtës për azil mbetën sfidë edhe më tej. Në procesin e shqyrtimit të një kërkesë për azil, mund të vërehet se Sektori shpesh i kushton vëmendje aspekteve teknike të kërkesës dhe fakteve që nuk janë relevante, e në disa raste nuk bën shqyrtim thelbësor dhe të detajuar të nevojës për mbrojtje ndërkombëtare në vend.

---

<sup>13</sup> Ky fakt konfirmohet edhe në [Raportin Vjetor të Kombeve të Bashkuara në Maqedoninë e Veriut për vitin 2020](#), fq. 15.

Në paditë e ngritura kundër vendimeve shpesh kërkohet përmirësim i arsytimit në vendime, nevoja që Sektori t'i marrë parasysh deklaratat dhe faktet relevante në lidhje me frikën nga persekutimi dhe t'i përcaktojë me saktësi faktet e rastit individual për secilën kërkesë për azil. Për më tepër, në disa aktvendime, arsyetimet e përdorura gjatë marrjes së vendimit nuk përmbajnë numër të mjaftueshëm faktesh të konfirmuara për situatën e aplikuesit dhe arsye të mjaftueshme pse disa prej pretendimeve nuk janë pranuar dhe anasjelltas. Prandaj, ShJRM-ja në disa raste identifikoi shkelje, sepse nuk janë marrë parasysh dhe nuk janë shqyrtuar në detaje as faktet përkatëse për vendin e origjinës, as ligjet dhe dispozitat në vendin e origjinës, si dhe deklaratat ose dokumentet përkatëse në lidhje me kushtet individuale të azilkërkuarit. Gjithashtu, gjatë prezencës së juristëve të ShJRM-së në intervista, u vu re dhe u vu në dukje se përdoreshin pyetje sugjeruese dhe bëhej evidentim selektiv i deklaratave të azilkërkuarëve në procesverbalin e bisedës. Në disa raste, kishte një numër më të madh të pyetjeve në lidhje me udhëtimin e azilkërkuarit sesa për frikën nga persekutimi. Kjo çon në shkelje serioze të së drejtës materiale.

**Në vitin 2020, Sektori i Azilit mori disa vendime negative të cilave duhet kushtuar vëmendje e veçantë, pasi ato i shkelin të drejtat e personave që kërkojnë mbrojtje ndërkombëtare të parapara në konventat ndërkombëtare dhe legjislacionin e vendit, dhe detyrimin e shtetit për ta shqyrtuar rastin në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe për të marrë vendim të drejtë.**

Në fakt, **Sektori në mënyrë të pabazuar nuk gjeti frikë nga persekutimi ose vuajtje të pasojave serioze për një fëmijë nga Afganistani, i cili pretendonte se ishte detyruar të largohej nga vendi për shkak të luftës, kërcënimeve dhe kidnapimit nga talebanët. Gjithashtu, në një rast të ngjashëm me këtë, që përfshinte një baba të vetëm nga Afganistani, i cili kishte ikur me dy fëmijët e tij të vegjël, Sektori nuk gjeti asnjë bazë për njohjen e të drejtës për mbrojtje ndërkombëtare.<sup>14</sup>**

Bile edhe në rastin e një nëne nga Siria me tre fëmijët e saj, e cila kishte ikur nga lufta në Siri dhe kishte frikë nga persekutimi, **Sektori i Azilit konstatoi se nuk kishte arsye për dhënien e mbrojtjes ndërkombëtare.** ShJRM-ja në këtë rast parashitri edhe ankesë me qëllim që të merret vendim më i shpejtë për shkak të tejkalimit të afatit për të marrë vendim dhe vonesën e tij të pajustificuar, veçanërisht sepse rasti përfshinte tre fëmijë refugjatë, njëri prej të cilëve ishte vetëm një vjeç e gjysmë dhe kishte nevojë urgjente për të kryer disa operacione për shkak të problemeve mjekësore. Në këtë rast, Avokati i Popullit konstatoi shkelje të të drejtave të fëmijëve, propozoi që procedura të përsëritet para Sektorit të Azilit dhe rekomandoi që ky organ t'i marrë parasysh rrethanat e rastit dhe arsyet e largimit nga Siria dhe të marrë një vendim me të cilin do të njihet mbrojtja e familjes. Megjithatë, pasi ankuesit u zhgënjyen me vendimin, ata u larguan nga vendi.

**Sektori i Azilit për një aplikuese nga Jemeni mori vendim me të cilin, gjithashtu, konstatoi se nuk ka frikë nga persekutimi ose nga pësimi i pasojave të rënda, duke mos e marrë parasysh faktin,**

<sup>14</sup> Më shumë rreth kësaj mund të shihet edhe në [Raportin vjetor mbi efikasitetin e mbrojtjes ligjore të të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë së Veriut - viti 2020](#), fq. 48.

se në Jemen në momentin e aplikimit dhe marrjes së vendimit ekziston kriza më e madhe humanitare në botë dhe se respektimi i të drejtave të njeriut është zvogëluar në minimum, me ç'rast njerëzit luftojnë për nevojat themelore të jetesës.<sup>15</sup>

Në rastet në të cilat Sektori i Azilit vendosi të ndërpresë mbrojtjen e dhënë, më shpesh për refugjatët nga kriza e Kosovës e vitit 1999, u konstatua zbatimi i gabuar i ligjit. Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri (LMNP) në vitin 2018, MPB-ja, në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme, publikoi një listë<sup>16</sup> në të cilën Kosova është shënuar si vend i sigurt i origjinës. Kështu, edhe pse sipas ligjit të ri, lista duhet të zbatohet për rastet që do të fillojnë pas hyrjes së tij në fuqi, Sektori filloi ta zbatojë këtë listë si dëshmi në rastet e refugjatëve të Kosovës nga kriza e vitit 1999, të cilët aplikuan për azil në vitin 2003. Kështu, në disa nga aktvendimet ishte shkruar: "Në të njëjtën kohë, në bazë të nenit 17, paragrafi 4 të Ligjit për Mbrojtjen Ndërkombëtare dhe të Përkohshme ('Gazeta Zyrtare e RM', nr. 64/18), Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Jashtme përgatiti një listë të vendeve të sigurta të origjinës, në mesin e të cilave është edhe Kosova". Në bazë të këtij konstatimi, shumë njerëzve iu ndërpre e drejta për azil sipas nenit 38 të LMNP-së, me arsyetimin se Kosova është vend i sigurt dhe se individët nuk mund të refuzojnë më mbrojtjen nga vendi i tyre. ShJRM-ja në paditë kundër këtyre aktvendimeve, duke i cituar raportet ndërkombëtare, argumentoi se Kosova nuk ishte një vend i sigurt për pakicat, ku bëjnë pjesë refugjatët kosovarë. Për më tepër, e drejta për azil, gjegjësisht mbrojtja ndërkombëtare, nuk mund dhe nuk duhet të përfundojë automatikisht vetëm në bazë të asaj liste dhe të vlejë përgjithësisht për të gjithë personat e prekur, kur secili rast kërkon një vlerësim individual dhe mundësinë që personi të dëshmojë të kundërtën. Nga ana tjetër, në vitin 2019, Sektori i dha mbrojtje ndërkombëtare një personi nga Kosova.

Në dhjetor të vitit 2019, në Gjenevë u mbajt Forumi Global i Refugjatëve, në të cilin Republika e Maqedonisë së Veriut u zotua se do ta rrisë kapacitetin për mbrojtjen e azilkërkesve dhe personave nën mbrojtje ndërkombëtare duke e forcuar menaxhimin e rasteve të azilit duke krijuar një bazë të dhënash të plotë për zbatim më efektiv të procedurave.<sup>17</sup>

Megjithatë, nga zotimi i dhënë e deri më sot, nuk është vënë re ndonjë përparim i rëndësishëm në këtë çështje dhe zbatimi i mekanizmave për menaxhim të forcuar nuk zbatohet në praktikë.

---

<sup>15</sup>

1.

<https://www.unhcr.org/yemenemergency.html#:~:text=After%20more%20than%20six%20years,a%20step%20away%20from%20famine;>

2.

<https://www.unicef.org/emergencies/yemencrisis#:~:text=Yemen%20is%20the%20largest%20humanitarian%20crisis%20in%20the%20world%2C%20with,more%20than%2012%20million%20children.>

<sup>16</sup> Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr. 56 e datës 15.03.2019.

<sup>17</sup> Deklaratë e Svetllana Gelevës (Drejtoreshë për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Bashkëpunim të Sigurisë në Ministrinë e Punëve të Jashtme të RMV-së) në Forumin Global të Refugjatëve, Gjenevë, 18.12.2019.

## • PROCEDURA PARA GJYKATAVE ADMINISTRATIVE

Pasi të merret aktvendimi nga Sektori, aplikuesi ka të drejtë të parashtrojë padi në Gjykatën Administrative të RMV-së. Në vitin 2020, nga ana e **ShJRM-së, e në emër të azilkërkuesve dhe personave nën mbrojtje, u ngritën gjithsej 29 padi. Në të njëjtën periudhë, Gjykata Administrative ka marrë vendim në lidhje me 19 raste, të cilat gjithashtu i referohen edhe padive të ngritura në vitin 2018 dhe 2019.**

Edhe pse, sipas LMNP-së, procedura para gjykatës është urgjente, mesatarisht, Gjykata Administrative merr vendim për 265 ditë pas ngritjes së padisë. Megjithatë, duhet theksuar se këtë vit Gjykata ka qenë më e shpejtë në marrjen e vendimeve.<sup>18</sup> Nga gjithsej 19 aktgjykime, Gjykata Administrative miratoi 8 aktgjykime pozitive dhe 11 negative. Kur bëhet fjalë për një aktgjykim pozitiv, kjo do të thotë që aktvendimi i Sektorit është anuluar dhe lënda është kthyer për rishqyrtim. Në periudhën e kaluar, në asnjë rast Sektori nuk solli vendim pozitiv pas pranimit të aktgjykimit pozitiv nga Gjykata Administrative për anulimin e aktvendimit. Në fund të vitit 2020, në Gjykatën Administrative kishte gjithsej 28 lëndë aktive.

Во изминатиот период во ниту еден случај Секторот не донесе позитивно решение по примена на позитивна пресуда од Управен суд за поништување решение. На крајот од 2020 година пред Управниот суд имаше вкупно 28 активни предмети.

Në anën tjetër, Gjykatës së Lartë Administrative i duhen pothuajse 500 ditë për të marrë vendim mbi ankesën ndaj një aktgjykimi të Gjykatës Administrative. ShJRM-ja parashtroi 10 ankesa para kësaj gjykate. Gjatë vitit 2020, Gjykata e Lartë Administrative vendosi për 24 lëndë për personat e përfaqësuar nga ShJRM-ja, në 10 prej të cilave mori vendim pozitiv, ndërsa në 14 vendim negativ.

Nga aktgjykimet e gjykatave administrative mund të konkludohet se sistemi gjyqësor në lidhje me çështjen e azilit u jep mbrojtje të veçantë fëmijëve, qoftë të pashoqëruar ose të shoqëruar, si dhe nënave të vetme. Këto dy kategori janë më shpesh të pranishme si të cenueshme, kështu që sistemi i azilit në shumicën e rasteve është i prirë t'i mbrojë ato.

Me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri për Kontestet Administrative,<sup>19</sup> Gjykata Administrative filloi mbajtjen e shqyrtimeve me gojë edhe në procedurat e azilit. Lidhur me procedurat për personat që përfaqësoheshin nga ShJRM-ja, u mbajtën gjithsej tre shqyrtime me gojë në procedurat për kërkesat e reja të parashtuara për azil dhe një shqyrtim në procedurat për personat me mbrojtje tashmë të njohur, të cilëve iu ndërpre e drejta e tyre me vendim të Sektorit të Azilit (bëhet fjalë për refugjatët nga kriza e Kosovës e vitit 1999). Në të gjitha procedurat në të cilat Gjykata

18 Në fakt, sipas LAMP-së, Gjykata Administrative duhet të vendosë në afat prej dy muajsh për procedurë të rregullt dhe në afat prej 30 ditësh për procedurë urgjente, kurse sipas LMNP-së së re, në nenin 43 (për procedurën e rregullt) dhe në nenin 49 (për procedurën urgjente) rregullohet që procedura para gjykatave është urgjente, pa dhënë një afat të caktuar. Në rastet në të cilat gjykatat vendosin në afat prej nëntë-dhjetë muajsh ose për një vit, mund të thuhet me siguri se kjo procedurë nuk është urgjente dhe nevojitet një zgjidhje më e shpejtë dhe më efikase e këtyre lëndëve.

19 Në nenin 9 të këtij ligji është përfshirë parimi i mbajtjes së shqyrtimeve me gojë, i cili thotë: "(1) Në pajtim me parimin e shqyrtimit me gojë, gjykata sipas rregullës, do të miratojë vendim në kontestin administrativ në bazë të shqyrtimit publik, të drejtpërdrejtë dhe me gojë. (2) Gjykata mund të vendos në kontestin administrativ pa mbajtjen e shqyrtimit vetëm në rastet e përcaktuara me këtë ligj.

Administrative mbajti shqyrtim me gojë u morën aktgjykime negative. Lidhur me procedurat e zhvilluara sipas Ligjit të vjetër për Kontestet Administrative, në parim, Gjykata Administrative e vazhdoi praktikën e kthimit të lëndëve para organit administrativ në rast të aktgjykimit pozitiv, pa mbajtur shqyrtim dhe pa vendosur në mënyrë meritore, edhe pse e ka këtë autorizim dhe obligim në disa lëndë në bazë të ligjit.

**Vendimi i gjykatave administrative vetëm nga aspekti i ligjshmërisë së vendimit mund të konsiderohet si një dështim ligjor dhe formal për të ofruar mbrojtje ndërkombëtare kur ekzistojnë kushtet për ofrimin e tij. Gjykata e Lartë Administrative solli një numër të madh aktgjykimesh pozitive në vitin 2020, kurse disa prej tyre për arsye teknike, gjegjësisht për shkak se avokati i personit me të cilin Sektori i Azilit ka zhvilluar intervistë nuk ishte nënshkruar në procesverbalin e intervistës, edhe pse është e shënuar si i pranishëm.**

**Si mangësi, ende vërehet zbatimi i pakët i vendimeve të marra nga GjEDNj-ja dhe i qëndrimeve të Gjykatës të shprehura në to.** Në thelb, është shqetësues fakti që praktika e GjEDNj-së nuk është marrë parasysh, pasi RMV-ja si palë e lartë Kontraktuese e KEDNj-së është e detyruar t'i respektojë plotësisht të drejtat e parapara nga KEDNj-ja dhe për këtë arsye duhet t'i respektojë edhe aktgjykimet përmes të cilave janë zbatuar dispozitat e KEDNj-së. Është e papranueshme që gjyqtarët vetëm në situata të jashtëzakonshme t'i përdorin aktgjykimet e GjEDNj-së si një korigjues thelbësor i sistemit dhe për këtë arsye nuk arrijnë të zhvillojnë një praktikë gjyqësore pozitive, si një mekanizëm tek i cili do të orientohen organet kompetente për ta respektuar plotësisht legjislacionin dhe të veprojnë me kujdes kur do të ndërmarrin ndonjë veprimi.<sup>20</sup>

Për më tepër, edhe pse RMV-ja nuk është ende anëtare e Bashkimit Evropian, megjithatë, në përputhje me aspiratat për hyrjen dhe harmonizimin e ligjeve të brendshme me legjislacionin e BE-së, gjykatat vendase gjithashtu duhet t'i përdorin edhe vendimet e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në mënyrën e veprimit dhe aplikimit të legjislacionit të BE-së, por edhe si udhëzues për arsyetimin ligjor.

---

<sup>20</sup> Megjithatë GjEDNj-ja nuk është "gjykatë azili" dhe e drejta për azil nuk është paraparë në mënyrë të drejtpërdrejt në KEDNj, megjithatë çdo vend nënshkruar ka detyrim t'ua garantojë të drejtat e parapara në KEDNj të gjithë personave që gjenden në territorin e tij. Prandaj, të drejtat e të gjithë qytetarëve janë edhe të drejta të azilkerkuesve, personave nën mbrojtje ndërkombëtare dhe emigrantëve, kështu që GjEDNj-ja ka zhvilluar një praktikë të caktuar në lidhje me këtë temë ndër vite.



## QENDRAT E PRANIMIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Qendrat e pranimi “Vinojug” dhe “Tabanoc” vazhduan të funksionojnë edhe në vitin 2020 nën kontrollin dhe menaxhimin e Qendrës për Menaxhim të Krizave (QMK). Qendrat janë të vendosura në afërsi të kufirit verior dhe atij jugor të vendit, atje ku hyjnë më së shpeshti ilegalisht refugjatët dhe emigrantët në vend. Këto qendra janë të vendosura në një zonë ku shteti ka shpallur gjendje krize, e cila zgjatet çdo gjashtë muaj. Të dy qendrat funksionojnë për të regjistruar personat që kalojnë (transitojnë) nëpër RMV. Hyrja në këto qendra nuk është e përcaktuar plotësisht dhe zakonisht varet nga dëshira e policisë se a do t’u lejojnë të hyjnë apo jo. Në QT Tabanoc zakonisht lejohet hyrja për të gjithë refugjatët dhe emigrantët të cilët shprehin dëshirën për të hyrë. Ndërkohë, në QT Vinojug më së shpeshti pranohen

kategori të cenueshme të refugjatëve dhe të emigrantëve, familje, fëmijë, si dhe refugjatë dhe emigrantë të kapur në aksione policore kundër kontrabandës ilegale.

Në vitin 2020, pati një ndryshim për sa i përket pranimin të refugjatëve dhe emigrantëve, sepse QT Vinojug u caktua si qendër e akomodimit në karantinë për të gjithë azilkërkuesit e rinj dhe personat e sapo gjetur me qëndrim të parregulluar në territorin e RMV-së. Për azilkërkuesit që ishin të akomoduar në këtë qendër, MPPS-ja sillte aktvendim për akomodim në karantinë. Nga ana tjetër, për personat që u mbajtën si dëshmitarë në procedurat kundër kontrabandistëve, nuk u mor asnjë vendim për akomodimin e tyre. Kjo konfirmohet edhe në raportin vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2020, ku thuhet: **“Për më tepër, gjatë vizitave u konstatua se për personat e sapo gjetur me qëndrim të parregulluar në territorin e R. të Maqedonisë së Veriut, nuk ka zgjidhje individuale për akomodimin e tyre, gjegjësisht për t’i mbajtur në Qendër, gjë që vetvetiu e ngre pyetjen për arbitraritetin e kufizimit të lirisë së tyre të lëvizjes”**.<sup>21</sup> Personat e mbajtur nuk kishin mundësi ta apelonin mbajtjen e tyre dhe nuk kishin qasje në të drejtat themelore që u takojnë personave të mbajtur. Gjatë kohëzgjatjes së karantinës 25-ditore, ata nuk u lejuan të dilnin nga kontejneri në të cilin qëndronin, përveç rasteve kur kishin nevojë për tualet vetëm dy herë në ditë, të shoqëruar nga një nëpunës policor. Me këtë rast, kontejnerët në të cilët ishin të vendosur ruheshin vazhdimisht nga policia.

Mekanizmi parandalues kombëtar i Avokatit të Popullit konstatoi se: "Megjithatë, AP-MPK konsideron se nevojitet një shkallë më e madhe e koordinimit dhe e komunikimit midis autoriteteve kompetente para marrjes së vendimeve. Në këtë kuptim, para marrjes së vendimit për akomodim në karantinë në Qendrën e Transitit “Vinojug” në Gjevgjeli për të gjithë azilkërkuesit e rinj, si dhe për personat e sapo gjetur me qëndrim të parregulluar në territorin e R. të Maqedonisë së Veriut, u konstatua se nuk janë marrë parasysh kushtet dhe kapacitetet e Qendrës për të mundësuar një akomodim të tillë, e as nuk janë marrë masa shtesë që do ta rregullonin veprimin e autoriteteve kompetente në kushtet e akomodimit në karantinë, që nënkupton domosdoshmërisht një mënyrë të ndryshuar të funksionimit, e të cilat në situatën e dhënë duhet të zbatohen në Qendër, e cila në kushte normale duhet të jetë e karakterit të hapur”<sup>22</sup>

Ajo që mbetet si çështje e paqartë është mënyra dhe procedura e pranimin në qendrat e transitit, statusi dhe lloji i këtyre qendrave dhe statusi dhe pozicioni i personave të akomoduar në to. Avokati i Popullit konstatoi se: "Mungesa e rregullave të qarta të veprimit, jo vetëm që ndikon në mungesën e koordinimit midis përfaqësuesve të organeve dhe organizatave të pranishme në Qendër në trajtimin e personave të mbajtur, por e imponojnë edhe rrezikun e trajtimit të mundshëm të papërshtatshëm dhe shkeljen e mundshme të të drejtave të tyre."<sup>23</sup> Prandaj, është me rëndësi të veçantë që statusi dhe trajtimi në këto qendra të rregullohet ligjërisht dhe të miratohet një akt i caktuar, një rregullore mbi statusin e qendrave dhe të personave, ose procedurë standarde operative për mënyrën e pranimin dhe akomodimit të tyre, për të drejtat dhe detyrimet dhe të ngjashme.

<sup>21</sup> [RAPORTI VJETOR PËR VITIN 2020 REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT PËR SHKALLËN E USHTRIMIT DHE MBROJTJES SË LIRIVE DHE TË DREJTAVE TË NJERIUT SIPAS FUSHAVE, fq. 77.](#)

<sup>22</sup> Po aty, fq. 76-77.

<sup>23</sup> Po aty, fq. 76.

Institucioni publik "Qendra e Pranimit të Azilkërkuesve" në Shkup mbeti institucioni i vetëm për akomodimin e azilkërkuesve në vend.

#### • KUSHTET NË QENDRAT E PRANIMIT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Kushtet në qendrat e pranimit janë të ndryshueshme në varësi të situatës në terren. Në këto qendra që ekzistojnë në RMV ka prezencë si të institucioneve shtetërore, ashtu dhe të organizatave ndërkombëtare që kujdesen për funksionimin e plotë të sistemit të azilit në vend dhe për t'u ndihmuar personave të akomoduar atje. Nga organet shtetërore, prezencë të përhershme kanë persona të punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe në Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale, të cilët i menaxhonin aktivitetet e përditshme në këto qendra. Gjatë vitit 2020, ShJRM-ja kishte prezencë si në QT Tabanoc ashtu edhe në QT Vinojug, duke ofruar ndihmë juridike falas, si dhe duke i informuar të pranishmit për të drejtën dhe procedurën e azilit, duke i ndihmuar në parashtrimin e kërkesës dhe duke ofruar mbështetje për ushtrimin e të drejtave të këtyre personave në procedurën e azilit. Megjithatë, për shkak të situatës me COVID-19, në tremujorin e dytë të vitit 2020 prezenca ishte me intensitet të zvogëluar me qëllim që të respektohen protokollet e miratuara nga shteti. Megjithatë, edhe në këtë situatë të re, juristët e ShJRM-së siguruan ndihmë dhe informacion juridik falas për refugjatët, emigrantët dhe azilkërkuesit për të drejtat e tyre në vend përmes mjeteve telekomunikuese dhe mënyrave online.

Në vitin 2020, nuk pati ndryshime për sa i përket kushteve në qendër, për dallim nga vitet e mëparshme.<sup>24</sup> Kjo do të thotë që u ofruan shërbimet themelore për personat e akomoduar në to, siç janë ushqimi, materialet higjienike dhe qasja në shërbimet shëndetësore. Shumica e njerëzve të vendosur në qendra ishin të kënaqur me kushtet dhe shërbimet që ishin në dispozicion të tyre. Një përjashtim nga kjo ishin ankesat e azilkërkuesve të vendosur në karantinë për shkak të kufizimit të lëvizjes. Në këto qendra kishte një prani të vazhdueshme të një mjeku, me kufizime të caktuara, i cili punonte në ndërrime, kryesisht në QT Tabanoc. Për ata që kishin nevojë për ndihmë mjekësore dhe vendosje në institucion shëndetësor, u siguroa transport, akomodim dhe shërim adekuat. Nuk kishte prezencë të një psikologu që ofron ndihmë psiko-sociale për personat e akomoduar në këto qendra, veçanërisht për kategoritë e cenueshme të njerëzve. Një lloj mbështetje u siguroa në QT Vinojug nga punonjësi social që ishte i pranishëm aty, kurse në QT Tabanoc biseda zhvillohej nga punonjësi social, por vetëm me disa fëmijë të pashoqëruar. Fëmijët që qëndrojnë në këto qendra ende nuk ishin përfshirë në arsimin formal.

<sup>24</sup> Më shumë për vitin 2018 dhe 2019 mund të shihni në raportin mbi Gjendjen e azilit në Republikën e Maqedonisë së Veriut, që është në dispozicion në gjuhën maqedonase dhe angleze në [www.myla.org.mk](http://www.myla.org.mk).



Ajo që përgjithësisht mbetet problem është se fëmijët që u gjenden në territorin e RMV-së pa prindër dhe pa kujdes prindëror ende nuk kishin qasje në mekanizmat mbrojtës që ekzistojnë për fëmijët sipas Ligjit për Mbrojtjen Sociale. Më konkretisht, mekanizmat mbrojtës që lidhen me format alternative të kujdesit dhe akomodimin e tyre në familje kujdestare, shtëpi të vogla grupore dhe forma të tjera që ofrohen për fëmijët shtetas të RMV-së. Kushtet, siguria dhe shërbimet që (nuk) janë në dispozicion në qendrat e transitit nuk korrespondojnë me nevojat e fëmijëve dhe nevojitet një shkallë më e madhe e mbrojtjes së tyre dhe zbatim i mekanizmave alternativë për kujdes dhe përkujdesje.

Qendrat nuk kishin asnjë aktivitet rekreativ dhe profesional në dispozicion për personat e akomoduar, veçanërisht duke pasur parasysh pandeminë dhe ndalimin për grupim.

BSa i përket pajisjeve dhe materialeve higjienike me qëllim të mbrojtjes nga virusi, u vu re se në QT Vinojug ka një koordinim më të madh për dhënien e pajisjeve të tilla personave të mbajtur, për dallim nga QT Tabanoc, ku vetëm herë pas here shpërndareshin maska.



## • QT “VINOJUG”

Për shkak të aktivitetit më të madh në kufirin jugor dhe numrit të madh të aksioneve të kryera nga policia në këtë zonë, numri i personave të përkujdesur në këtë qendër është dukshëm më i lartë se në QT Tabanoc. Ajo që është shqetësuese është mungesa e një procedure formale për pranimin e njerëzve në qendër dhe mundësia që policia të vendosë se cilët persona do të përkujdesen atje.

**Gjatë vitit 2020, numri i përgjithshëm i personave të regjistruar, por edhe të paregjistruar në QT Vinojug, sipas statistikave të ShJRM-së, është 26.894 persona, nga të cilët për 2.955 persona ShJRM-ja ka ofruar ndihmë dhe këshillim juridik, kurse gjithsej 31 parashtruan kërkesë për azil në këtë qendër.<sup>25</sup>**

Për shkak të KOVID-19, ndjeshëm u vështirësua qasja në shërbime për personat e mbajtur në QT Vinojug, të cilët ishin vendosur në karantinë, dhe të cilët ishin ose azilkërkues ose persona të mbajtur si dëshmitarë në procedurën kundër kontrabandistëve.<sup>26</sup> Midis personave të mbajtur të cilëve u ishte kufizuar liria e lëvizjes kishte familje dhe fëmijë mbi të cilët një mbajtje e tillë ndikon ndjeshëm në zhvillimin e tyre dhe duhet të konsiderohet si mjet i fundit. Këta persona kishin mundësi të vizitonin tualetin vetëm dy herë në ditë të shoqëruar nga një nëpunës i MPB-së. Azilkërkuesit duhej të kalonin një karantinë 25-ditore (e cila më vonë u zëvendësua me një karantinë 14-ditore), dhe më pas transferoheshin në Qendrën e pranimit në Shkup.

Të tjerët që akomodoreshin në QT Vinojug ishin persona të mbajtur si dëshmitarë në procedurat kundër kontrabandistëve dhe ata fillimisht u testuan për praninë e koronavirusit, dhe në rast të rezultatit negativ, ata nxirreshin para Prokurorisë Publike për të dhënë dëshmi, dhe më pas ktheheshin në mënyrë joformale në Greqi.

**Në vitin 2020, gjithsej 48 azilkërkues u vendosën në karantinë në QT Vinojug.** Disa prej tyre e parashtruan kërkesën për azil, kurse disa prej tyre e parashtruan kërkesë për azil derisa ishin akomoduar atje, dhe më pas u transferuan në Qendrën e pranimit. Ankesat më të mëdha vijnë nga personat e vendosur në karantinë, të cilët vunë në dukje se u është kufizuar liria e lëvizjes dhe se janë të mbyllur brenda, se janë vazhdimisht nën kontrollin e një nëpunësi të policisë dhe se nuk kanë mundësi të kalojnë pak kohë në ajër të pastër.

<sup>25</sup> Të dhënat nga raportet në terren të ShJRM-së janë në dispozicion [www.myla.org.mk](http://www.myla.org.mk).

<sup>26</sup> Për më shumë informata mund të shihni Raportin mbi paraburgimin për arsye të emigrimit në Maqedoninë e Veriut përmes numrave për periudhën janar-shtator 2020, i cili është në dispozicion në [maqedonisht](http://maqedonisht) dhe [anglisht](http://anglisht) në [www.myla.org.mk](http://www.myla.org.mk).

Të gjithë kishin qasje në shërbimet shëndetësore të ofruara në terren, qasje në tre ushqime në ditë, qasje në internet dhe produkte higjienike. Nëse ndonjë prej emigrantëve shprehte dëshirën për produkte të caktuara, ato bliheshin nga dyqani. Një punonjës social ishte në dispozicion në qendër çdo ditë pune dhe në fundjavë në rast se thirrej, i cili bisedonte me kategoritë e cenueshme të emigrantëve. I njëjti punonjës social u caktua kujdestar i të gjithë fëmijëve të mbajtur të pashoqëruar në qendër. Megjithatë, shkalla e nevojshme e mbështetjes psiko-sociale për të cilën kishin nevojë një pjesë e emigrantëve mungonte në qendër.

Përveç faktit se statusi i qendrës nuk është i rregulluar formalisht, personat e akomoduar atje nuk kanë mundësi të dalin nga qendra lirshëm dhe, de facto, liria e tyre e lëvizjes është e kufizuar. Pas fillimit të pandemisë së KOVID-19, procesi i regjistrimit të refugjatëve dhe emigrantëve u ndërpre sipas rekomandimeve të shtetit për respektimin e masave shëndetësore.


Në mesin e të gjithë personave të akomoduar në qendër, kishte fëmijë të pashoqëruar të cilët më së shpeshti u kapën në procesin e kontrabandës dhe si kategori e personave të cenueshëm u vendosën në këtë qendër. Alternativat për mbajtjen e fëmijëve për arsye emigrimi nuk u gjetën gjatë vitit 2020, duke i lënë fëmijët pa qasje në të drejtat dhe shërbimet që duhet t'u ofrohen. Pas akomodimit, atyre iu caktua një kujdestar nga Qendra për Punë Sociale në Gjevgjeli, i cili ka për detyrë të kujdeset për interesin më të mirë të fëmijës. Në vitin 2020, numri i kërkesave për azil të parashtruara në emër të fëmijëve të pashoqëruar u ul ndjeshëm, sepse kujdestarët vlerësuan se për disa nga fëmijët nuk ishte në interesin e tyre të parashtronin kërkesë për azil. Në vitin 2020, të gjithë fëmijët azilkërkues u vendosën në QP për azilkërkuesit, përveç një fëmije të pashoqëruar, i cili u vendos në një familje kujdestare në Shkup. Ky ishte një përjashtim nga praktika e vendosur, kurse arsyeja ishte mosha e hershme e fëmijës. Një fëmijë pësoi një aksident të rëndë në territorin e RMV-së në të cilin u përplas nga një tren dhe për shkak të kësaj njëra këmbë iu amputua. Pas shtrimit në spital, për një periudhë të caktuar, ai u vendos në QT Vinojug, ku iu dha kujdesi i nevojshëm mjekësor, dhe më pas u transferua në Shkup. Kujdestari parashtrroi kërkesë për njohjen e së drejtës për azil në emër të tij dhe kërkesa e tij u pranua nga ana e organeve kompetente.

#### • QT TABANOC

Në kufirin verior, në afërsi të të cilit ndodhet QT Tabanoc, aktiviteti dhe lëvizjet e refugjatëve dhe emigrantëve janë me intensitet më të ulët. Numri i aksioneve të policisë është shumë më i vogël dhe në përputhje me këtë edhe numri i njerëzve të akomoduar në këtë qendër është më i vogël. Zakonisht, në këtë qendër transiti u akomoduan emigrantët e kthyer nga policia nga territori i Serbisë, kështu që ata vetë vijnë në qendër dhe kërkojnë që të akomodohen në të. Për shkak të mungesës së një procedure formale të pranimit në qendër, policia është ajo që vendos se kush do të pranohet. Shumica e refugjatëve dhe emigrantëve që qëndronin në QT Tabanoc ishin burra të rritur të moshës prej 18 deri në 50 vjeç, që kryesisht vinin nga Siria, Afganistani, Pakistani, Bangladeshi, Irani, Iraku dhe vende të tjera. Para pandemisë së koronavirusit, intervistat me këta persona u zhvilluan nga ana e MPPS-së dhe ShJRM-së dhe kështu u identifikuan nevojat e tyre individuale në mënyrë më të detajuar. Mirëpo, me fillimin e pandemisë, MPPS-ja zhvilloi intervista me kategoritë e cenueshme të njerëzve, edhe atë më shpesh me fëmijë të pashoqëruar. SJHRM-ja zhvillonte intervista në ambient të hapur kur kushtet e mundësonin këtë dhe duke i respektuar masat kufizuese në vend.

Në vitin 2020, shumica e refugjatëve dhe emigrantëve u transportuan nga QT Tabanoc në një pikë të caktuar joformale në kufirin me Greqinë. Policia herë pas here i transferonte disa prej personave në mënyrë të organizuar. Shumica e tyre shprehën dëshirën për t'u kthyer në Greqi. Në periudhën raportuese, u siguruan vetëm kushtet më elementare për jetesë të emigrantëve, të tilla si ushqimi, paketë higjienike, e herë pas here u siguruan maska mbrojtëse dhe shërbime mjekësore. Ndonjëherë emigrantëve u jepeshin rroba dhe kishin mundësi për të përdorur kompjuter. Aktivitetet e tjera që ishin në dispozicion gjatë viteve të mëparshme dhe të cilat ofroheshin nga shumë organizata nuk janë më në dispozicion. Në këtë qendër mungon ofrimi i mbështetjes psiko-sociale, aktivitete të organizuara për fëmijët dhe shkollimi i tyre, si dhe mundësia për aktivitete rekreative. Kjo është arsyeja pse shumica e njerëzve të pranishëm në kamp qëndruan vetëm disa ditë para se të vazhdonin vetë udhëtimin e tyre ose të ndihmoheshin nga policia gjatë kësaj. Gjatë vitit 2020, numri i përgjithshëm i personave të regjistruar dhe të akomoduar në QT Tabanoc është 2.308 persona, nga të cilët për 1.321 persona ShJRM-ja ofroi ndihmë dhe këshillim juridik, kurse gjithsej tre persona parashtruan kërkesë për azil në këtë qendër.<sup>27[4]</sup> Gjatë vitit 2020, një kujdestar u emërua për të gjithë fëmijët e vendosur në këtë qendër dhe u zhvillua bisedë me shumicën e tyre. Megjithatë, për asnjë fëmijë të pashoqëruar nuk u parashtrua kërkesë për azil sipas vlerësimit se kjo nuk ishte në interesin e tyre më të mirë. Fëmijët dhe familjet u vendosën në hapësira-kontejnerë të veçantë, të ndarë nga emigrantët e tjerë.

### Struktura gjinore dhe moshë e azilkërkuesve



<sup>27</sup> Të dhënat nga raportet në terren të ShJRM-së janë në dispozicion në [www.myla.org.mk](http://www.myla.org.mk).

## • QENDRA E PRANIMIT PËR AZILKËRKUESIT

Institucioni publik për akomodimin e azilkërkuesve, Qendra e pranimit të azilkërkuesve - Vizbeg është një institucion unik i këtij lloji, qëllimi kryesor i të cilit është akomodimi dhe kujdesi për azilkërkuesit.

Pas shfaqjes së pandemisë së KOVID-19, disa nga aktivitetet dhe hapësirat e përbashkëta në këtë qendër nuk u vunë në përdorim për të parandaluar dhe mbrojtur nga koronavirusi, për shembull qendra e fitnesit, qendra kompjuterike dhe aktivitetet e tjera në grupe. Megjithatë, në gjysmën e dytë të vitit 2020, qendra mori iniciativën për të prezantuar përmbajtje të reja arsimore, veçanërisht për fëmijët e vendosur në Qendrën e pranimit. Nga fundi i vitit, për të gjithë personat e interesuar për të mësuar gjuhën maqedonase, u organizuan orë nga një profesor, i cili punonte, mbi të gjitha, me fëmijët e pranishëm në Qendrën e pranimit. Gjithashtu, të gjithë fëmijët u regjistruan në shkollë dhe e ndoqën mësimin online. Përmes donacioneve, u siguruan pajisje teknike për ndjekjen e pandërprerë të mësimin.

Deri në fillimin e pandemisë së KOVID-19 aplikuesve u siguroheshin nga tre ushqime në ditë, çdo ditë të javës. Megjithatë, që nga fillimi i pandemisë, për shkak të mbrojtjes, si të punonjësve, ashtu edhe të azilkërkuesve, këto tre ushqime shpërndaheshin përnjëherë çdo ditë të javës. Të gjithë aplikuesit kishin qasje te mjeku, i cili ishte i pranishëm çdo ditë pune të javës në orë të caktuara të ditës. Në muajt e parë pas shfaqjes së pandemisë, pas futjes së masave kufizuese për lëvizje në territorin e vendit, Qendra mori vendim për kufizimin e lëvizjes së aplikuesve jashtë Qendrës. Pastaj, me zvogëlimin e intensitetit të masave, ata u lejuan të lëviznin më lirshëm, dhe më pas u lejuan të lëvizin lirë edhe jashtë Qendrës. Gjithashtu, u siguruan mjete për dezinfektim për punonjësit dhe azilkërkuesit, si dhe maska mbrojtëse dhe pajisje të tjera mbrojtëse. Bëhej dezinfektimi dhe pastrimi i rregullt i hapësirave. Për më tepër, u instalua një sistem dezinfektimi për automobilat që hynin në Qendër dhe shpërndarës për dezinfektimin e duarve.

ShJRM-ja kishte një prani të vazhdueshme në këtë Qendër dhe duke ofruar ndihmë juridike falas siguroi këshilla dhe konsultime ligjore, mbrojtje të të drejtave të aplikuesve dhe përfaqësim gjatë procedurave të tyre të azilit. Përmes komunikimit të përditshëm me aplikuesit dhe referimit të nevojave të tyre në Qendër, kërkesat dhe ankesat e tyre u plotësuan dhe u realizuan. Për t'u mbrojtur kundër virusit, si dhe për të siguruar ndihmë juridike dhe për t'i kryer intervistat me azilkërkuesit, në një dhomë të veçantë në këtë Qendër u instaluan pajisjet që u dhuruan nga ShJRM-ja. Përveç kësaj, SHJRM-ja përmes shfaqjes së videove në televizor mundësoi shfaqjen e informatave më të rëndësishme në lidhje me parandalimin dhe mbrojtjen nga virusi dhe masat që zbatohen në vend në disa gjuhë.



## **MBAJTJA PËR ARSYE TË EMIGRIMIT**

Në vitin 2020, refugjatët dhe emigrantët vazhduan të kalojnë përmes RMV-së, duke përdorur rrugë të parregullta dhe kontrabanduese. Si përgjigje, mbajtja e të huajve për arsye emigrimi ishte dukuri në rritje, duke ngritur shqetësime për shkelje të mundshme të të drejtave të njeriut të shtetasve të huaj të mbajtur. Gjatë vitit 2020, hyrja dhe vizitat e ShJRM-së në Qendrën e pranimi për të huajt ende nuk ishin të mundësuar. Mirëpo, në të njëjtën kohë, në QT Vinojug u mbajtën persona si dëshmitarë në procedurat kundër kontrabanduesve, me qëllim të mbrojtjes nga koronavirusi dhe akomodimit parandalues në karantinë. Prandaj, për shkak të pranisë së përditshme të ShJRM-së në këtë Qendër, bëhej monitorimi i rregullt i mbajtjes së personave dhe i kushteve, dhe për ta u ofrua informacion mbi të drejtën e mbrojtjes ndërkombëtare kur u mundësua nga policia që të kontaktoheshin personat e mbajtur. Asnjë vendim për akomodim ose mbajtje të këtyre personave nuk është marrë në QT Vinojug. Gjatë mbajtjes së tyre, ata kishin mundësinë të dilnin vetëm dy herë për të shkuar në tualet, edhe atë në prani të një nëpunësi të policisë. Shumica e refugjatëve dhe e emigrantëve të mbajtur ishin nga Pakistani, Afganistani, Bangladeshi dhe Turqia. **Si arsye për mbajtje përsëri shfaqet dëshmimi në procedurat penale, edhe pse sipas dispozitave dhe normave ligjore pozitive kjo nuk është bazë për mbajtjen e tyre.**

Sipas informacioneve të marra përmes një kërkesë të parashtruar për qasje të lirë në informatat me karakter publik, në periudhën prej 1.1.2020 deri më 31.12.2020, gjithsej 119 persona u mbajtën në Qendrën e Pranimit për të Huajt në Shkup, dhe për gjithsej 95 persona u sigurua ndihmë juridike.<sup>28</sup> Gjithsej 13 fëmijë u mbajtën në këtë qendër, shtatë prej të cilëve ishin të pashoqëruar, dhe në të njëjtën kohë u mbajtën pesë gra me gjashtë fëmijë. Nga numri i përgjithshëm i azilkërkuesve, në vitin 2020 janë parashtruar 83 kërkesa për azil për 87 persona. Nga ana tjetër, numri i personave të mbajtur në QT Vinojug është shumë më i madh se në Qendrën e Pranimit për të Huajt dhe sipas statistikave të ShJRM-së ai është 233 persona, nga të cilët 39 janë fëmijë të pashoqëruar.

Koha mesatare e mbajtjes së të rriturve dhe fëmijëve është 16 ditë, ndërsa koha më e gjatë e mbajtjes në këtë qendër është 55 ditë. Fëmijëve të pashoqëruar iu caktua kujdestar në kohën e duhur. Megjithatë, praktikat ndryshojnë, kështu që kujdestarëve të fëmijëve të mbajtur në QT Vinojug nuk u është dhënë gjithmonë qasje për të biseduar me fëmijët.<sup>29</sup> Për më tepër, disa nga fëmijët që u mbajtën në QP për të Huajt dhe në QT Vinojug u vendosën në një dhomë me të rritur të tjerë, gjë që është e papranueshme dhe në kundërshtim me standardet vendore dhe ndërkombëtare për mbajtjen e fëmijëve. Gjithashtu, fëmijët nuk ishin të përfshirë në arsim, as nuk kishin qasje në programe arsimore dhe interaktive.<sup>30</sup> Në vitin 2020, nuk u gjetën alternativa për mbajtjen e fëmijëve për arsye emigrimi, të cilat sipas të drejtës ndërkombëtare nuk duhet të mbahen për arsye emigrimi.

Edhe pse në legjislacionin e vendit, më saktësisht në Ligjin për Mbrojtjen Sociale, ekzistojnë mekanizma alternativë për kujdesin dhe përkujdesjen e fëmijëve për akomodimin e tyre jashtë qendrave të tilla, në forma të ndryshme të kujdesit siç janë shtëpitë e vogla grupore ose familjet kujdestare, megjithatë ato nuk zbatohen për fëmijët e huaj, duke i shkelur kështu të drejtat e tyre.

Personat e mbajtur në QT Vinojug si dëshmitarë në procedurat penale nuk kishin mundësi për qasje në ndihmë juridike dhe konsultime para skadimit të periudhës së caktuar për akomodim në karantinë ose para se të marrin rezultat negativ nga testi PCR i bërë, ndërsa për azilkërkuesit kjo vlente deri në skadimin e periudhës për akomodim në karantinë, të përcaktuar nga MPPS-ja. Ata nuk e kuptonin arsyen dhe kohëzgjatjen e mbajtjes së tyre, duke pasur parasysh faktin se ata ishin vendosur në karantinë për 25 ditë para se të merreshin për të dëshmuar. Për shkak të pamundësisë për të pasur qasje në ndihmë juridike, disa prej tyre personalisht ose përmes të afërmeve të tyre jashtë qendrës, përdorën rrjetet sociale për të kontaktuar me ShJRM-në ose iu drejtuan drejtpërdrejt Avokatit të Popullit të RMV-së përmes parashtrësve.

Në RMV ende nuk ka në dispozicion alternativa për mbajtjen e personave për arsye emigrimi. Përkundër dispozitës ligjore se mbajtja e një të huaji që zgjat më shumë se 12 orë duhet të shqyrtohet nga një gjyqtar, nuk ka praktikë që tregon se kjo respektohet dhe praktikohet.

<sup>28</sup> Aktvendimi nr. 16.12-208/1 për t'iu përgjigjur kërkesës për qasje të lirë në informatën e kërkuar nga Ministria e Punëve të Brendshme e RMV-së.

<sup>29</sup> [Paraburgimi për arsye emigrimi në Maqedoninë e Veriut përmes numrave, janar-shtator 2020.](#)

<sup>30</sup> Po aty



## INTEGRIMI

### • INTEGRIMI I HERSHM

LMNP-ja parashikon disa të drejta që u takojnë azilkërkuesve, të cilat e përbëjnë termin integrim i hershëm. Mbi të gjitha, këto janë e drejta për arsim, e drejta për punë dhe e drejta për mbrojtje sociale. Neni 61 i këtij ligji e garanton edhe qasjen në programet e disponueshme të integritit të hershëm. Strategjia për Integrimin e Refugjatëve dhe të Huajve në Republikën e Maqedonisë 2017-2027 e MPPS-së<sup>31</sup> gjithashtu flet për integrimin e hershëm, por ajo ende nuk është miratuar. Udhëzimet kryesore për integrimin e hershëm në përputhje me këtë strategji janë mësimi i gjuhës maqedonase dhe ndjekja e trajnimeve profesionale për të rritur kapacitetin e punësimit të azilkërkuesve, pasi kjo është me rëndësi thelbësore për një integrim të qëndrueshëm. Gjithashtu janë paraparë kurse për integrim të hershëm që ofrojnë orientim kulturor dhe informacion mbi mënyrën e jetesës në Maqedoninë e Veriut dhe për bazat e legjislacionit vendas. Segmenti më i rëndësishëm i integritit është arsimimi i fëmijëve dhe regjistrimi i tyre në një shkollë të rregullt. Për këtë, në këtë raport, më shumë bëhet fjalë në pjesën për fëmijët refugjatë dhe azilkërkuesit. Kyç është obligimi i shtetit për të siguruar një mjedis në të cilin azilkërkuesit mund, në një fazë të hershme, të fitojnë aftësi që do të kontribuojnë në pavarësinë e tyre të ardhshme, kurse ekzistimi i programeve arsimore dhe profesionale bëhet i detyrueshëm. Mirëpo, këto aktivitete zbatohen përmes organizatave ndërkombëtare, siç është UNHCR-ja, përmes programeve për mbështetje dhe integrim, dhe ato nuk sigurohen nga një mekanizëm shtetëror.<sup>32</sup> Në vitin 2020, pengesa më e madhe për angazhimin dhe përfshirjen në më shumë aktivitete ishte koronavirusi, për shkak të të cilit shumë

---

<sup>31</sup> <http://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/strategji/%D0%A1%D1%82%D1%80%D0%B0%D1%82%D0%B5%D0%B3%D0%B8D1%98%D0%B0%20%D0%B7%D0%B0%20%D0%B8%D0%BD%D1%82%D0%B5%D0%B3%D1%80%D0%B0%D1%86%D0B8%D1%98%D0%B0%20%D0%BD%D0%B0%20%D0%B1%D0%B5%D0%B3%D0%B0%D0%BB%D1%86%D0%B8%20%D0BA%D0%BE%D0%BD%D0%B2%D0%B5%D1%80%202017.pdf>

<sup>32</sup> Më shumë për integrimin e azilkërkuesve dhe personave nën mbrojtje ndërkombëtare mund të lexoni në [Raportin vjetor për rezultatet të Kombeve të Bashkuara në Maqedoninë Veriore në vitin 2020](#), fq. 11.



aktivitete u anuluan me qëllim të mbrojtjes dhe parandalimit. Megjithatë, edhe këtë vit organizimi i kurseve të gjuhës maqedonase, duke përfshirë edhe kurset e integritit për fëmijë dhe të rritur, siç parashihet në strategji, nuk u sigurua nga shteti si një proces i vazhdueshëm për integrimin e këtyre personave.

**E drejta për punë është një nga të drejtat themelore ekonomike të njeriut e njohur në të gjitha dokumentet ndërkombëtare që e rregullojnë këtë fushë. Kjo e drejtë është paraparë edhe për azilkërkuesit në LMNP-në e re, edhe atë si më poshtë: “Deri sa të merret vendimi përfundimtar në procedurën e azilit, azilkërkuesit kanë të drejtë për: – Punë vetëm brenda Qendrës së Pranimit ose vendbanimit tjetër të përcaktuar nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe të drejtën për qasje falas në tregun e punës për azilkërkuesin, për kërkesën e të cilit për njohjen e së drejtës për azil nuk është marrë vendim nga Sektori i Azilit, për një periudhë jo më të gjatë se nëntë muaj pas parashtrimit të kërkesës”.<sup>33</sup>**

Megjithatë, kjo dispozitë është e parregullt dhe e kundërshton mundësinë për ushtrimin e kësaj të drejte, duke i lënë azilkërkuesit pa qasje në tregun e punës. Në fakt, ky ligj u miratua në përputhje me direktivat e BE-së në këtë fushë me qëllim të harmonizimit të legjislacionit me BE-në, duke përfshirë edhe Direktivën 2013/33, e cila i rregullon standardet për pranimin e kërkuesve të mbrojtjes ndërkombëtare.<sup>34</sup> Në këtë Direktivë, neni 15 paragrafi 1 e rregullon të drejtën për punë dhe përcakton se: **secili shtet do të sigurojë që azilkërkuesit të kenë të drejtë të hyjnë në tregun e punës pas skadimit të nëntë muajve nga parashtrimi i kërkesës për azil, nëse nuk është marrë vendim i shkallës së parë nga organi kompetent.** Pikërisht kjo është përfshirë në LMNP, siç u tha më lart. **Megjithatë, paragrafi 3 i nenit 15 të Direktivës thekson se qasja në tregun e punës nuk do të kufizohet derisa zgjasin procedurat ankuese, kur mjeti juridik kundër vendimit negativ në procedurën e rregullt ka efekt pezullues derisa të dorëzohet vendimi negativ në lidhje me ankesën. Kjo e fundit nuk është pjesë përbërëse e zgjidhjes sonë ligjore, e me këtë humbet kuptimi i së drejtës për qasje në tregun e punës, e cila parashikohet nga Direktiva dhe u mundësohet azilkërkuesve.** Në praktikë, kjo konsiderohet e drejtë vetëm nëse Sektori nuk ka marrë vendim brenda nëntë muajve nga parashtrimi i kërkesës, mirëpo nuk merren parasysh procedurat e ankimit kundër vendimit, të cilat i përmend në mënyrë eksplicite Direktiva.

**Prandaj, mund të konkludohet se kjo e drejtë ekonomike është e kufizuar për azilkërkuesit dhe ata praktikisht nuk janë në gjendje të jenë pjesë e tregut të punës dhe të kontribuojnë në shoqërinë e Maqedonisë së Veriut për shkak të pasaktësisë ligjore dhe mosharmonizimit të ligjit me legjislacionin e BE-së.**

<sup>33</sup> Neni 61, paragrafi 1, alineja 10 i LMNP-së.

<sup>34</sup> DIRECTIVE 2013/33/EU OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 26 June 2013, Standards for the reception of applicants for international protection (recast), : <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32013L0033&from=EN>.

Në vitin 2020, kjo e drejtë ende ishte e pamundësuar për azilkërkuesit.<sup>35</sup> Procedura të cilën ShJRM-ja e filloi në vitin 2019 për të drejtën e punës dhe konstatimin e diskriminimit ndaj një azilkërkuesi, deri në ditën e publikimit të këtij raporti nuk u zgjidh dhe për shkak të koronavirusit shumica e shqyrtimeve me gojë u shtynë. Në vitin 2020, ShJRM-ja parashtrori një ankesë te Avokati i Popullit në dy raste për shkak të pamundësisë të kësaj të drejte dhe nevojës për të ndryshuar zgjidhjet ligjore, dhe këto parregullsi u konstatuan edhe nga vetë Avokati i Popullit. Në procedurë, ai dha një rekomandim dhe udhëzim për ta ndryshuar Ligjin për Mbrojtjen Ndërkombëtare dhe të Përkohshme dhe Ligjin për Numrin Amë, gjë që do ta lehtësonte dhe do ta mundësonte qasjen e azilkërkuesve në tregun e punës. Përveç pengesave të theksuara më sipër, si problem për qasjen në tregun e punës ende mbetet mungesa e mundësisë për të përcaktuar numër amë për një azilkërkues, gjë që do ta lehtësonte procesin e regjistrimit në Agjencinë e Punësimit të RMV-së, hapjen e një llogarie bankare dhe të gjitha proceset e tjera që lidhen me punësimin. Për më tepër, Agjencia e njohu këtë problem dhe dërgoi një letër që do t'i drejtohet drejtpërdrejt MPPS-së me qëllim që ta zgjidhë këtë çështje duke shqyrtuar dhe ndërmarrë aktivitete për rregullimin përkatës të dispozitave ekzistuese ligjore. Mirëpo, nuk ka asnjë ndryshim në lidhje me këtë çështje.

Përveç të drejtës për punë, një pjesë kyçe e jetës private dhe familjare të një personi është e drejta për t'u martuar. E drejta për t'u martuar rregullohet me Ligjin për Familjen, si dhe me nenin 12 të KEDNJ -së. **Në vitin 2019, një azilkërkuese deklaroi se donte të martohej me një shtetas të Maqedonisë së Veriut dhe se i kishte të gjitha dokumentet e parashikuara me ligj, të përkthyer në maqedonisht nga një përkthyes i autorizuar gjyqësor.** Me dokumentacionin e nevojshëm, ajo parashtrori kërkesë në njësinë kompetente të Drejtorisë për Udhëheqjen e Librave Amë për martesë. **Megjithatë, për arsye të panjohura nuk është ndërmarrë asnjë veprim në lidhje me kërkesën** dhe ajo u përçoll për shqyrtim në Drejtorinë për Udhëheqjen e Librave Amë në Shkup. **Pas kërkesave të shumta dhe urgjencave për rastin, ShJRM-ja ngriti padi pranë Gjykatës Administrative për heshtjen e administratës, në përputhje me nenin 22 të LKA-së.** Megjithatë, Gjykata Administrative në vitin 2020 solli një aktgjykim negativ, duke theksuar se padia e parashtruar është e parakohshme, sepse nuk është kryer procedura e duhur para organeve administrative. ShJRM-ja nuk u pajtua me këtë aktgjykim dhe për këtë arsye ajo parashtrori ankesë në Gjykatën e Lartë Administrative. **Avokati i Popullit udhëzoi që të eliminohen shkeljet e dispozitave në këtë rast, por kjo nuk u bë. ShJRM-ja vëren një diskriminim aktiv të shkaktuar nga praktika e organeve.** Përveç kësaj, ShJRM-ja ngriti një padi në Gjykatën Themelore Shkup 2 në këtë rast, me qëllim të konstatimit të shkeljes së nenit 8 të KEDNJ-së, gjegjësisht të së drejtës për jetën private dhe familjare dhe të së drejtës për martesë të parashikuar nga neni 12 i KEDNJ-së, për shkak të parandalimit të aplikuesit për të lidhur martesë, edhe pse i plotëson kërkesat ligjore.<sup>36</sup>

Në vitin 2020, nuk u njoh atësia e një qytetari të Maqedonisë për një foshnje të porsalindur, të lindur nga një azilkërkuese, e cila e kishte dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm, megjithëse me të njëjtat dokumente vitin e kaluar ishte regjistruar dhe ishte njohur atësia e fëmijës së saj të parë nga i njëjti baba.

<sup>35</sup> Më shumë rreth kësaj mund të shihet edhe në [Raportin vjetor mbi efikasitetin e mbrojtjes ligjore të të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë së Veriut - viti 2020, fq. 49](#)

<sup>36</sup> Po aty

DULA kërkoi certifikatë të lindjes nga vendi i origjinës dhe një certifikatë të statusit të lirë martesor jo më të vjetër se gjashtë muaj, pa marrë parasysh faktin se ajo është azilkërkuese në vend dhe nuk duhet të kontaktojë me vendin amë. Me këtë rast, me të njëjtën certifikatë lindjeje, edhe pse me datë më të vjetër, fëmija u regjistrua në librin amë të të lindurve, pa e lejuar njohjen e atësisë. Për më tepër, aplikuesja u informua pa shpjegim se ajo mund të kërkojë njohjen e atësisë në gjykatë ose nga Qendra për Punë Sociale, të cilat, përveç DULA-s, janë organe kompetente për këtë çështje.<sup>37</sup>

#### • INTEGRIMI I REFUGJATËVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Në bazë të neneve 67-75 të LMNP-së, refugjatët e njohur kanë të njëjtat të drejta dhe detyra si edhe shtetasit e Maqedonisë së Veriut, me përjashtim të së drejtës për të votuar, angazhimit në profesione ku është e përcaktuar me ligj se personi duhet të jetë shtetas i RMV-së ose t'i nënshtrohet shërbimit ushtarak. Ata mund të fitojnë të drejtën për prona të luajtshme dhe të paluajtshme, të angazhohen në marrëdhënie pune, të kenë të drejtën e mbrojtjes sociale, mbrojtjes shëndetësore, arsimit, etj. Në përputhje me nenet 77 dhe 78 të të njëjtit ligj, personat nën mbrojtje plotësuese janë të barabartë me qytetarët e vendit në lidhje me ushtrimin e së drejtës për mbrojtje sociale, shërbime shëndetësore dhe akomodim. Sa i përket të drejtave të tjera, statusi i tyre është i barabartë me të huajt me leje qëndrimi.

Procesi i integrimit lokal është i ndërlikuar dhe gradual dhe përfshin dimensione të ndryshme jo vetëm juridike, ekonomike, sociale, por edhe kulturore, të cilat në realitet imponojnë kërkesa të rëndësishme, si për individin ashtu edhe për shoqërinë.<sup>38</sup>

Në kuadër të politikës kombëtare, procesi i integrimit i drejtohet vetëm refugjatëve të njohur dhe personave nën mbrojtje subsidiare, si dhe në kushte të caktuara, personave të tjerë që kanë krijuar lidhje të ngushta me shtetasit e Maqedonisë së Veriut dhe kanë vendbanim të regjistruar. Kjo do të thotë që pasi të jetë vendosur në lidhje me kërkesën për azil dhe të miratohet statusi, integrimi lokal mund të fillojë zyrtarisht.

Është e rëndësishme të theksohet se, megjithëse integrimi i refugjatëve dhe i personave nën mbrojtje subsidiare është organizuar përmes pushtetit qendror - MPPS-së, sipas nenit 70 të LMNP-së: "Parimi i pjesëmarrjes lokale nënkupton detyrimin e njësive të vetëqeverisjes lokale të pranojnë përgjegjësinë për akomodimin e personave me status të refugjatit dhe personave nën mbrojtje subsidiare në varësi të zhvillimit ekonomik dhe numrit të banorëve të njësive të vetëqeverisjes lokale, për çka vendos Qeveria e Republikës së Maqedonisë".

<sup>37</sup> Po aty

<sup>38</sup> Për një pasqyrë më të plotë të integrimit, ShJRM-ja publikoi një analizë për qasjen në mbrojtjen sociale dhe natyralizimin, në vitin 2016, që është në dispozicion në: <https://myla.org.mk/wp-content/uploads/2016/09/ACCESS-TO-SOCIAL-PROTECTION-AND-NATURALIZATION-FOR-REFUGEES-AND-PERSONS-UNDER-SUBSIDIARY-PROTECTION-IN-THE-REPUBLIC-OF-MACEDONIA.pdf>.

Në fund të vitit 2020, numri i përgjithshëm i personave nën mbrojtje subsidiare të pranishëm në RMV ishte shtatë. Këtu bëhet fjalë për njerëz që kanë qenë azilkërkues të rinj, që vijnë nga vendet jashtë rajonit. Prandaj, kur bëhet fjalë për integrimin e refugjatëve, në shumicën e rasteve bëhet fjalë për integrimin e refugjatëve nga kriza e Kosovës e vitit 1999 për shkak të qëndrimit të tyre shumëvjeçar në vend si persona nën mbrojtje ndërkombëtare. Kjo është arsyeja pse përvoja e tyre është më e rëndësishme kur bëhet fjalë për këtë proces.

Nga përvoja e deritanishme, vërehet se problemi më i madh për njerëzit që nuk vijnë nga një zonë e ngjashme e të folurit është pengesa gjuhësore dhe ata kërkojnë, mbi të gjitha, ta mësojnë gjuhën maqedonase. Gjatë vitit 2020, u siguruan mësimet të gjuhës maqedonase nga UNHCR-ja të cilat u mbajtën nga partnerët e tyre. Gjithashtu, në bashkëpunim me partnerët, personat nën mbrojtje u përfshinë në programin shtetëror të punësimit përmes Agjencisë së Punësimit të RMV-së duke mundësuar ndjekjen e kurseve (për shembull, për gatim, parukeri, etj.). Mjetet për qëndrim në çerdhet e fëmijëve për një kohë të caktuar u mbuluan nga donacionet, por ndërkohë u arrit një marrëveshje me komunën ku jetojnë këta persona dhe regjistrimi i fëmijëve ishte falas. Mirëpo, gjatë këtij viti nuk ka pasur programe zyrtare për mësimin e gjuhës maqedonase të ofruara nga shteti, gjë që çon në një numër problemesh për këta njerëz, siç është qasja në tregun e punës, arsim dhe ushtrimi i të drejtave të tjera që u takojnë. Përveç kësaj, nuk ka zgjidhje sistemore që do t'i udhëhiqnin refugjatët në procesin e pavarësimit dhe integrimin të plotë në shoqëri.



## **INTEGRIMI I REFUGJATËVE NGA KRIZA E KOSOVËS E VITIT 1999 NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT**

Në vitin 2019, ShJRM-ja përfaqësoi 367 refugjatë që u larguan nga Kosova, kryesisht romë, ashkali dhe egjiptianë (RAE) në RMV, ndërsa në vitin 2020 numri i përgjithshëm i refugjatëve të përfaqësuar është 317.

Deri në vitin 2020, gjithsej 14 persona kanë statusin të njohur të refugjatit, ndërsa 138 prej tyre janë persona nën mbrojtje subsidiare në vend. Nga ana tjetër, gjithsej 118 personave u ka përfunduar e drejta e azilit me një vendim përfundimtar, ndërsa për 86 persona procedura e azilit është duke vazhduar. Numri i fundit i përfshin ata që e drejta për azil u është ndërprerë me aktvendim të Sektorit, por lënda e tyre është në procedurë për shkak të padisë ose ankesës para organeve administrative dhe gjykatave.<sup>39</sup>

Gjatë këtij viti, Sektori miratoi 80 aktvendime për këta refugjatë, nga të cilët 37 për vazhdimin e mbrojtjes subsidiare dhe dy për miratimin e statusit të mbrojtjes subsidiare. Nga ana tjetër, u miratuan 41 aktvendime për përfundimin e mbrojtjes ndërkombëtare në vend.

Në punën e saj njëmbëdhjetëvjeçare me refugjatët kosovarë, ShJRM-ja mund të vërejë se refugjatët e mbetur në vend janë në një pozitë të palakmueshme sepse ata kanë qenë të pranishëm në RMV për më shumë se 20 vjet, pa u ndërmarrë asnjë veprim nga shteti për të zgjidhur përgjithmonë çështjen e tyre. Rrethanat dhe situata në të cilat gjenden ata mbeten të pandryshuara nga vitet e mëparshme.<sup>40</sup> Siç mund të shihet nga të dhënat, disa prej tyre janë ende nën mbrojtje, kurse për disa prej tyre procedura e azilit ka përfunduar përfundimisht ose është në vazhdim e sipër pas aktvendimit të miratuar për ndërprerjen e së drejtës për azil. Për disa prej tyre, procedurat zgjasin nga katër ose pesë vjet derisa të merret një vendim përfundimtar. Deri më tani, kishte zgjidhje të përkohshme/afatshkurtra për të rregulluar qëndrimin e tyre, por gjithçka varej nga rasti në rast dhe në çfarë situatë ishte personi konkret. Mirëpo, mbeti i lartë numri i personave që nuk mund ta rregullojnë qëndrimin e tyre për arsye të tjera, kryesisht për shkak të pamundësisë për ta siguruar dokumentacionin e nevojshëm që u kërkohet nga autoritetet e RMV-së, gjë që në thelb tregon se lënia e gjërave rastësisë nuk është zgjidhje e përhershme. Nga ky aspekt, kyç ishte zotimi i Qeverisë së RMV-së i dhënë para Kombeve të Bashkuara në Forumin Global të Refugjatëve se vendi do ta zgjidhë situatën shumëvjeçare të refugjatëve të mbetur nga Kosova duke u dhënë status ligjor afatgjatë në vend, të gjithë atyre që janë të kualifikuar për këtë.

<sup>39</sup> Më shumë informacion mund të shihet në infografikun e ShJRM-së: "Situata e refugjatëve të Kosovës nga viti 1999 në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2011-2019", që gjendet në: [www.myla.org.mk](http://www.myla.org.mk).

<sup>40</sup> Për vitin 2018 dhe 2019 mund ta shikoni raportin për Gjendjen e azilit në RVM për vitin 2018-2019, fq 50.

Mirëpo, në praktikë, nuk ndërmerret asnjë veprim konkret nga shteti për sa i përket zgjidhjes së përhershme të statusit të tyre ligjor, gjegjësisht nga e gjithë kjo nuk kishte rezultate të dukshme.

Personat me të drejtë të njohur të azilit në RMV, veçanërisht refugjatët nga kriza e Kosovës e vitit 1999, përballen me pengesa të ndryshme në procesin e integritit të tyre, veçanërisht në procedurat para Drejtorisë për Udhëheqjen e Librave Amë, Sektorit për Shtetësi në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe Qendrave për Punë Sociale (QPS) në MPPS. Në përgjithësi, problemi më i madh është se autoritetet në vend u kërkojnë dokumente që duhet t'i marrin nga vendi amë i origjinës, e të cilin, si rregull, nuk duhet ta kontaktojnë sepse janë nën mbrojtje ndërkombëtare. Në vazhdim, mund të gjendet një përmbledhje e shkurtër e problemeve që lidhen me realizimin e dy të drejtave kryesore përmes të cilave është paraqitur integrimi në vend.

#### • E DREJTA PËR NATYRALIZIM

Sipas nenit 7-a të Ligjit për Shtetësinë (LSh)<sup>41</sup> një person me status të njohur të refugjatit mund të marrë nënshtetësinë e RMV-së me natyralizim, nëse nga njohja e statusit të refugjatit deri në parashtrimin e kërkesës për shtetësi, ai ligjërisht banon vazhdimisht në territorin e vendit për të paktën gjashtë vjet. Për sa i përket personave nën mbrojtje subsidiare, mund të zbatohet neni 7 i LSh-së. Pastaj, një i huaj që ka aplikuar personalisht për nënshtetësinë e RMV-së mund të marrë shtetësinë me natyralizim nëse ka një vendbanim të ligjshëm dhe të përhershëm në territorin e vendit për të paktën tetë vjet. **Mirëpo, edhe pse kjo kërkesë është përmbushur, ka edhe kushte të tjera nga LSh-ja që në fakt kërkojnë sigurimin e dokumenteve nga vendi i origjinës, të tilla si: vërtetim se nuk zhvillohet asnjë procedurë penale, vërtetim për mosndëshkim dhe vërtetim për lirim nga shtetësia e mëparshme. Përveç këtyre dokumenteve, Sektori për Shtetësi i Ministrisë së Punëve të Brendshme kërkon dokumente që nuk janë të përcaktuara në LSh, siç janë certifikata e lindjes dhe certifikata e martesës (nëse personi është i martuar).** Gjithashtu, në procedurën e lidhjes së martesës së një personi nën mbrojtje ndërkombëtare, si një nga mundësitë për natyralizim, si dokumente të nevojshme nga Drejtoria për Udhëheqjen e Librave Amë në Ministrinë e Drejtësisë, ndër të tjera, kërkohen edhe dokumente nga vendi i origjinës - certifikata e lindjes dhe certifikata e martesës.

Mund të vërehet se **çdo kërkesë parashikon vendosjen e kontaktit me vendin e origjinës të personave me interes.** Në këto raste ekziston rreziku për krijimin e një problemi ekzistencial dhe të sigurisë për këta persona, për faktin se ata e kanë të njohur të drejtën për azil në RMV, pas largimit nga vendi i tyre i origjinës ose vendi i tyre i shtetësisë, nga frika e persekutimit dhe frika për sigurinë e jetës së tyre. Kërkesa e këtyre dokumenteve është e padiskutueshme dhe kontradiktore kur merret parasysh fakti se këtyre personave u është njohur e drejta e azilit, ata janë nën mbrojtje ndërkombëtare dhe nuk mund të kontaktojnë me vendin e tyre të origjinës. Të gjitha dokumentet e tyre personale dhe dokumentet që kanë të bëjnë me statusin e tyre në vend lëshohen dhe janë nën kompetencën e Sektorit të Azilit të MPB-së.

<sup>41</sup> "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 67/1992, 8/2004, 98/2008, 158/2011 dhe 55/2016.

Për sa i përket dëshmisë së nevojshme në lidhje me vendbanimin, neni 7 i LSh-së, ndër kushtet e tjera, e përmban edhe kushtin se i huaji "duhet të ketë siguruar banesë". Shumica e personave nën mbrojtje subsidiare jetojnë në shtëpi me qira që janë në proces të legalizimit (për shkak të qirasë së ulët) ose i nënshtrohen procedurës së trashëgimisë dhe pronarët e atyre shtëpive nuk kanë fletëpronësi (aktzotërim). Sektori i Shtetësisë si dëshmi për vendin e banimit e konsideron posedimin e fletëpronësisë (aktzotërimit) për ndërtesën për banim ose marrëveshjen për qira të vërtetuar nga një noter (për lidhjen e kësaj kontrate te një noter kërkohet fletëpronësi për objektin që është dhënë me qira), edhe pse kjo nuk është parashikuar në ligj.

Në periudhën raportuese, një person kishte parashtruar kërkesë për pranim në shtetësinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut, kurse gjithsej tre persona morën nënshtetësinë e Maqedonisë së Veriut.

#### • E DREJTA PËR MBROJTJE SOCIALE

Sipas Ligjit për Mbrojtjen Sociale,<sup>42</sup> të gjithë refugjatët dhe personat nën mbrojtje subsidiare kanë qasje në mbrojtje sociale dhe shëndetësore. Qasja dhe gëzimi i të drejtave sociale është i barabartë me atë që u ofrohet qytetarëve të Maqedonisë së Veriut. QPS është përgjegjëse për menaxhimin e lëndëve të mbrojtjes sociale dhe është përgjegjëse për sigurimin e informacionit dhe mbështetjes së duhur për refugjatët gjatë përgatitjes dhe dorëzimit të kërkesës së tyre për ndihmë sociale.

**Ekziston një problem në lidhje me pamundësinë për të ushtruar të drejtën për ndihmë sociale për të gjithë familjen nëse vetëm një anëtar nuk ka ose e humbet statusin e personit nën mbrojtje subsidiare ose nuk ka numër unik amë të qytetarit (NUAQ), edhe pse kjo e drejtë është e garantuar për personat me të drejtë të njohur të azilit në përputhje me nenin 71 dhe nenin 77 të LMNP-së.**

**Një problem tjetër lind kur e drejta për ndihmë sociale e të gjithë familjes përfundon (pezullohet) për shkak të mjeteve financiare të marra për të mbuluar shpenzimet e ushqimit dhe transportit për ndjekjen e trajnimit profesional. Ekziston gjithashtu rreziku i ndërprerjes të së drejtës për ndihmë sociale për të gjithë familjen për shkak të mosdorëzimit në kohë të certifikatës së lindjes ose NUAQ-së për foshnjën e porsalindur.**

Kjo ndodh sepse procedurat para Drejtorisë për Udhëheqjen e Librave Amë për regjistrimin e një foshnje të porsalindur, prindërit e të cilit kanë status të njohur të azilit, janë dukshëm më të gjata se sa procedurat për qytetarët e Maqedonisë së Veriut. Prindërit me status të njohur të azilit duhet të marrin një certifikatë për statusin e tyre nga Sektori i Azilit në MPB dhe ta dorëzojnë atë te Drejtoria. Për më tepër, pas marrjes së certifikatës së lindjes nga DULA, ajo duhet të dorëzohet te Sektori, ku lëshohet NUAQ-ja për të porsalindurin, në mënyrë që fëmija të ketë qasje në të drejtën për ndihmë sociale. **Organet kompetente e përdorin në mënyrë jo të drejtë dhe të gabuar Ligjin për Marrjen dhe Shkëmbimin e Provave dhe të Dhënave sipas detyrës zyrtare, në dëm të shfrytëzuesve të ndihmës sociale dhe të drejtave të tjera të garantuara me ligjet e vendit.** Institucionet duhet të kenë parasysh se ata vendosin për jetën e kategorive jashtëzakonisht të cënueshme të njerëzve që jetojnë në vend.

<sup>42</sup> "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 104/2019, 146/2019 dhe 275/2019.



## KATEGORIT E CENUESHME

### • FËMIJËT

Sipas LMNP-së, person i moshës së mitur është i huaji i cili nuk i ka mbushur 18 vjet, kurse person i moshës së mitur i pashoqëruar është i huaji që nuk i ka mbushur 18 vjet dhe arrin në territorin e RMV-së pa shoqërimin e prindit ose kujdestarit, ka mbetur pa shoqërimin e tillë pasi që ka hyrë në territorin e vendit, apo për të cilin nuk ekziston kujdes efektiv.<sup>43</sup> Në këto dy përkufizime mund të vërehet se nuk është respektuar termi i njohur ndërkombëtarisht "fëmijë", i cili duhet të përdoret në vend të shprehjes person i moshës së mitur ose ndonjë mënyrë tjetër e të shprehurit, që përdoret në vend të termit fëmijë.<sup>44</sup>

---

<sup>43</sup> Neni 2, pikat 10 dhe 11 të LMNP-së.

<sup>44</sup> Shih Konventën e KB-së për të Drejtat e Fëmijëve të vitit 1989, që gjendet në: <https://www.unicef.org/child-rights-convention/convention-text>.



Fëmijët refugjatë dhe azilkërkuesit janë një nga kategoritë e cenueshme të njerëzve të cilëve duhet t'u kushtohet vëmendje e veçantë. LMNP-ja siguron mbrojtje për fëmijët që shoqërohen nga prindi ose kujdestari i tyre, si dhe për ata që janë të pashoqëruar. Gjatë vitit 2020, është vënë re rënie e numrit të familjeve me fëmijët e tyre që largohen nga vendi i tyre i origjinës, kurse është vënë re rënie edhe më e madhe e numrit të fëmijëve të regjistruar të pashoqëruar. **Kështu, nëse merret parasysh se në vitin 2019 kishte 94 azilkërkues fëmijë të pashoqëruar, në vitin 2020 numri u zvogëluar në 19 azilkërkues fëmijë të pashoqëruar. Mirëpo, ajo që është shqetësuese, është se numri i fëmijëve të mbajtur për arsye të emigracionit është 76,<sup>45</sup> nga të cilët numri i fëmijëve të mbajtur të pashoqëruar është 46.** Megjithatë, ShJRM-ja nuk mund të konfirmojë nëse shifrat janë objektive për faktin se nuk ka një procedurë formale për vlerësimin e moshës së fëmijës. Të gjithë fëmijët regjistrohen si të tillë sipas deklaratës së tyre. Në disa raste, pas bisedës me azilkërkues të tjerë, u zbulua se disa fëmijë raportojnë qëllimisht moshë më të madhe gjatë regjistrimit nga policia për t'u kthyer në Greqi me grupin me të cilin udhëtojnë dhe të mos ndalen gjatë rrugës. Kjo ndodh për faktin se gjatë kontaktit me një fëmijë të pashoqëruar, në përputhje me Procedurat Standarde Operative për veprimin me fëmijët e huaj të pashoqëruar,<sup>46</sup> policia e njofton menjëherë QPS-në për ndërmarrjen e hapave të ardhshëm. Për çdo azilkërkues fëmijë të pashoqëruar, u caktua një kujdestar nga QPS-ja, i cili e parashtron kërkesën në emër të tij, duke marrë parasysh gjininë dhe nevojat e fëmijës. Detyra e kujdestarit është të bëjë një vlerësim fillestar të rrezikut, të bëjë një vlerësim të nevojave dhe të zhvillojë një plan për ndihmë, adaptim dhe stabilizim. Kjo duhet bërë sa më shpejt që të jetë e mundur që fëmijët të marrin mbrojtjen e nevojshme, si dhe informacion në lidhje me të drejtat e tyre në procedurën e azilit. Për më tepër, fëmijët përmes kujdestarëve të tyre ose përfaqësuesve ligjorë nga ShJRM-ja i shprehin nevojat dhe interesat e tyre dhe më pas u përcilleshin organeve kompetente. ShJRM-ja i përfaqësoi të gjithë fëmijët e pashoqëruar që aplikuan për azil gjatë këtij viti.

Gjatë viteve të mëparshme, kur vendoste për një kërkesë për azil, veçanërisht për një fëmijë të pashoqëruar, Sektori e merte parasysh cenueshmërinë e tij dhe nevojat e tij, kështu që secilit fëmijë të pashoqëruar që aplikoi për azil dhe me të cilin u zhvillua bisedë, iu njoh e drejta për azil dhe atij iu dha mbrojtje subsidiare.

Megjithatë, në vitin 2020 kjo praktikë ndryshoi dhe Sektori i Azilit për herë të parë vendosi ta refuzojë kërkesën për njohjen e së drejtës për azil për dy fëmijë nga Afganistani dhe Pakistani. Nga ana tjetër, mbrojtja subsidiare iu dha dy fëmijëve nga Afganistani.

<sup>45</sup> Në bazë të vendimit të MPB-së për informatat me karakter publik, ShJRM-ja u informua se nga janari deri në shtator në Qendrën e Pranimat për të Huajt kishte 17 fëmijë të mbajtur, e pasi kjo informatë u kërkuar sërish nga MPB-ja për periudhën nga janari deri në dhjetor, gjithsej 13 fëmijë ishin mbajtur në këtë qendër. Prandaj, numri i përgjithshëm i fëmijëve të mbajtur gjatë gjithë vitit korrespondon me numrin e treguar në [Raportin për paraburgimin për arsye të emigrimit për periudhën janar - shtator 2020](#).

<sup>46</sup> Procedurat Standarde Operative për Veprim me Fëmijët e Huaj të Pashoqëruar, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, Komisioni Kombëtar për Luftimin e Trafikimit me Qenie Njerëzore dhe Migrimit Ilegal, viti 2015, gjendet në: <http://nacionalnakomisija.gov.mk/wp-content/uploads/2016/12/SOP-za-postapuvanje-so-nepridruzuvani-deca-stranci.pdf>.

Përqindja e ulët e mbrojtjes së dhënë është si rezultat i asaj se shumë nga fëmijët u larguan para se të vendosej për kërkesën e tyre për azil.

Gjithashtu, Sektori e merr parasysh situatën e azilkërkesve që janë prindër të vetëm me fëmijë dhe në përputhje me rrethanat e rastit jep mbrojtje. Mirëpo, edhe në këtë pjesë, në vitin 2020 u vërejt një ndryshim në praktikë, kështu që nëse Sektori në vitet e mëparshme e njihte mbrojtjen subsidiare të nënave të vetme me fëmijë, këtë vit ai e refuzoi kërkesën për njohjen e së drejtës për azil të një babai të vetëm me dy fëmijë nga Afganistani, me kërkesë të arsyeshme për azil dhe nevojën për mbrojtje ndërkombëtare me arsyetimin se nuk ka frikë nga persekutimi dhe vuajtja e pasojave serioze për këtë familje në Afganistan.

**Pas miratimit të Ligjit për Arsimin Fillor, në fund të vitit 2019, azilkërkesve fëmijë iu dha mundësia të bëhen pjesë e arsimit fillor formal, edhe pse ende nuk ishin miratuar programet mësimore.** Në vitin 2020, me shfaqjen e pandemisë dhe ndalimin e prezencës fizike në klasa dhe futjen e mësimin online, për fëmijët azilkërkes përmes donacioneve u blenë tableta me të cilët ata vazhduan ta ndiqnin mësimin. Lidhur me fëmijët që janë nën mbrojtje ndërkombëtare, disa prej tyre kishin problem për shkak të mungesës së pajisjeve teknike për të ndjekur mësimin. Ata fëmijë, prindërit e të cilëve nuk kishin mjete për pajisje teknike, e ndërprejnë ndjekjen e mësimin. Një problem kryesor mbeti pamundësia e fëmijëve të vendosur në QT që të kenë qasje në programet arsimore dhe shkencore që të mund të arsimohen dhe t'i ndjekin mësimet e nevojshme për zhvillimin e tyre.

**Gjatë praktikës, në periudhën e kaluar kishte raste kur fëmijët e pashoqëruar janë përdorur si dëshmitarë në procedurat penale kundër kontrabandistëve. Sipas PSO-së për trajtimin e fëmijëve të huaj, një fëmijë i pashoqëruar nuk mund të përdoret si dëshmitar në procedurat penale, përveç kur ai është dëshmitari i vetëm në atë procedurë penale:** "Fëmija i mitur i pashoqëruar i huaj duhet të përdoret si dëshmitar vetëm në raste të jashtëzakonshme, kur ai është dëshmitari i vetëm dhe nuk ka prova të tjera materiale në procedurën kundër autorëve."<sup>47</sup> **Megjithatë, me rritjen e numrit të fëmijëve, këto raste u rritën në proporcion të drejtë dhe fëmijët u përdorën gjithnjë e më shumë si dëshmitarë. Në vitin 2019, u mbajtën gjithsej 30 fëmijë, kurse në vitin 2020 ky numër u dyfishua në 76 fëmijë, që është një dukuri alarmuese dhe është e nevojshme që urgjentisht të ndërmerren masa për të mbrojtur të drejtat e fëmijëve dhe për të gjetur alternativa ndaj mbajtjes së tyre. Mbajtja e fëmijëve për arsye emigrimi në kushte që i ngjajnë paraburgimit asnjëherë nuk është në interesin e tyre më të mirë.<sup>48</sup>** Kjo ishte pasojë e asaj se kur policia gjeti refugjatë që transitonin në mënyrë ilegale, fëmijët u ndanë nga grupi me qëllim që të sigurohet siguria dhe mbrojtja e tyre dhe më vonë ata u përdorën si dëshmitarë në procedurat kundër kontrabanduesve, me qëllim që të zvogëlohet kontrabanda e emigrantëve. Pas dëshmisë së tyre, ata ose lirohen nga policia ose kujdestarët e tyre parashtrajnë kërkesë për azil në emër të tyre dhe vendosen në Qendrën e Pranimit. Në vend ende nuk janë gjetur mënyra për të monitoruar zhvillimin dhe nevojat e fëmijëve në atë masë sa ata do të qëndronin këtu për faktin se ata shumë shpesh largohen nga vendi menjëherë, pa i shqyrtuar nevojat dhe interesat e tyre. Prandaj, nevojitet një mekanizëm për mbrojtjen dhe kontrollin e fëmijëve dhe për punë të vazhdueshme me ta, që do krijonte një sistem bashkëpunimi dhe mbështetjeje për të mbrojtur interesat e tyre më të mira.

<sup>47</sup> Po aty, fq. 38.

<sup>48</sup> <https://www.refworld.org/pdfid/5885c2434.pdf#:~:text=In%20this%20context%2C%20UNHCR's%20position,never%20in%20their%20best%20interests.&text=non%2Ddetention%20of%20children%20for%20immigration%20related%20purposes.>

- **DHUNA SEKSUALE DHE AJO ME BAZË GJINORE**

Në vitin 2018, RMV-ja e ratifikoi Konventën e Stambollit.<sup>49</sup> Neni 60 i kësaj Konvente parashikon që: Palët do t'i marrin masat e nevojshme legjislative apo të tjera për të siguruar se dhuna me bazë gjinore kundër grave mund të njihet si një formë persekutimi brenda kuptimit të nenit 1, A(2), të Konventës së vitit 1951 lidhur me Statusin e Refugjatëve, dhe si një formë e dëmtimit të rëndë që shkakton mbrojtje plotësuese/mbështetëse. Gjithashtu, Palët duhet të sigurojnë një interpretim me ndjeshmëri gjinore për secilin nga arsytet e Konventës dhe se aty ku është përcaktuar që persekutimi i mundshëm ndodh për një ose më shumë nga këto arsye, aplikuesve do t'u jepet statusi i refugjatëve në bazë të instrumenteve të zbatueshme përkatëse.<sup>50</sup>

Në ligjin e vendit, neni 6 i LMNP-së përcakton se veprat e përndjekjes mund të kenë formën e dhunës fizike ose mendore, duke përfshirë edhe veprat e dhunës seksuale, dhe neni 7, i cili i përshkruan bazat e frikës nga përndjekja, në pjesën e përkatësisë në një grup të caktuar, elementet që lidhen me gjininë, të cilat e përfshijnë identitetin gjinor, duhet të merren parasysh gjatë caktimit të anëtarësisë apo karakteristikës së grupit të caktuar social. Nga ana tjetër, Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje ishte ende në proces të miratimit në vitin 2020. ShJRM-ja ishte pjesë e grupit të punës për përgatitjen e ligjit dhe, ndër të tjera, dha rekomandime përkatëse për të harmonizuar Konventën e Stambollit me ligjin për t'i kushtuar vëmendje të veçantë personave që kërkojnë mbrojtje për shkak të ekzistimit të dhunës me bazë gjinore ose dhunës në familje, duke i marrë parasysh format e persekutimit që janë specifike për përkatësinë gjinore. Megjithatë, deri në fund të periudhës raportuese, ligji ende nuk ishte miratuar. Në këtë drejtim, duhet të theksohet se në Forumin Global të Refugjatëve, vendi u zotua se do të krijojë një sistem të mbrojtjes nga dhuna seksuale dhe me bazë gjinore sipas Konventës së Stambollit, që përfshin mbrojtjen e refugjatëve dhe të azilkërkuësve.

**Kuptimi dhe përmbajtja e Konventës së Stambollit janë përdorur në dy raste në vitin 2020 nga ana e ShJRM-së për të mbrojtur të drejtat e azilkërkuësve në lidhje me kërkesën e tyre të parashtruar për azil. Mirëpo, Sektori i Azilit nuk e mori parasysh konventën dhe vendosi në kundërshtim me udhëzimet për respektimin e saj. Në këto raste u mor vendim negativ dhe ajo që mbetet shqetësuese është se nuk u dha asnjë shpjegim për pretendimet dhe zhvillimet në lidhje me këtë konventë, gjegjësisht ajo nuk u mor parasysh.**

---

<sup>49</sup> Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, gjendet në linkun e mëposhtëm: <https://rm.coe.int/168046253a>.

<sup>50</sup> Për më tepër, neni 61 e rregullon parimin e moskthimit të viktimave të dhunës ndaj grave. Një përmbledhje gjithëpërfshirëse e këtyre dy neneve mund të gjendet në analizën e Këshillit të Evropës: [GENDER-BASED ASYLUM CLAIMS AND NON-REFOULEMENT: ARTICLES 60 AND 61 OF THE ISTANBUL CONVENTION](#).

Në fund të vitit 2017, u parashtrua kërkesa e parë për azil për shkak të persekutimit të kryer për shkak të përkatësisë në një grup të caktuar social, më saktësisht për shkak të orientimit seksual. LAMP-ja që ishte në fuqi në atë kohë nuk e veçonte orientimin seksual si një arsye të veçantë për persekutim, por tani e ajo është paraparë në LAMP. Megjithatë, në këtë rast, kërkesa për azil u refuzua dhe aktvendimi u konfirmua me aktgjykim të Gjykatës Administrative.<sup>51</sup> Procedura përfundoi në mënyrë të plotfuqishme në vitin 2020 me aktgjykim negativ nga Gjykata e Lartë Administrative, në të cilën nuk u konstatua asnjë shkelje materiale në procedurën e azilit.

Në vitin 2020, me shfaqjen e pandemisë, me kufizimin e lirisë së lëvizjes së njerëzve në vend, duke i përfshirë edhe azilkërkuesit, u raportua dhuna me bazë gjinore kundër dy grave azilkërkuese. ShJRM-ja i referoi rastet tek organet kompetente, por ankueset nuk donin të vazhdonin me procedurën dhe ta raportonin rastin në polici. Megjithatë, në të dy rastet, Qendra për Punë Sociale doli menjëherë në terren dhe bisedoi me ankueset.



<sup>51</sup> Aktgjykimi U-6, nr. 72/2018 i datës 18.04.2019 i Gjykatës Administrative të RMV-së.

## REKOMANDIME

### ● Qasja në territor:

- Organet kompetente nuk duhet të bëjnë kthimin kolektiv të refugjatëve përtej kufirit jashtë procedurës formale dhe duhet të bëhet vlerësim individual për çdo rast, veçanërisht duke i marrë parasysh kategoritë e cenueshme të refugjatëve.
- Organet kompetente në RMV duhet ta respektojnë procedurën ligjore dhe vendimin për dëbim në lidhje me kthimin e refugjatëve përtej kufirit.
- Kthimi i të huajve duhet të bëhet vetëm në përputhje me ligjet dhe procedurën e ripranimit.
- Është e nevojshme të gjendet një zgjidhje e përshtatshme për vendosjen e azilkërkuesve në karantinë ose ndonjë mënyrë tjetër e pranimit të tyre, e cila ka bazë ligjore dhe që është e rregulluar ligjërisht.

### ● Qasja në procedurë:

- Kërkesat për azil duhet të regjistrohen pa vonesë në të gjitha vendet e parashikuara nga LMNP-ja, si dhe procesi i regjistrimit dhe i lëshimit të dokumenteve të identifikimit duhet të zhvillohet pa pengesa brenda afatit ligjor.
- Procedura për qasjen në qendrat e transitit duhet të jetë formale, si dhe rregullimi i statusit ligjor të personave të akomoduar në QT.
- Është e nevojshme të gjendet një zgjidhje e përshtatshme për vendosjen e azilkërkuesve në karantinë ose ndonjë mënyrë tjetër e pranimit të tyre, e cila ka bazë ligjore dhe që është e rregulluar ligjërisht.

### ● Procedura e azilit:

- Organet kompetente duhet t'i përpunojnë dhe t'i vlerësojnë siç duhet të gjitha kërkesat për njohjen e së drejtës për azil, duke i marrë parasysh raportet përkatëse të vendeve të origjinës së azilkërkuesve. MPB-ja duhet të fillojë me shqyrtimin e plotë të bazave të tjera, jo aq të shpeshta, për persekutim, që e plotësojnë përkufizimin sipas Konventës për Statusin e Refugjatit.
  - Gjatë zbatimit të procedurës për secilin rast individual, duhet të respektohen afatet e përcaktuara me ligj.
  - Organi i shkallës së parë është i detyruar t'i respektojë dhe t'i zbatojë udhëzimet e dhëna nga gjykatat në aktgjykimet e tyre, të cilat gjatë marrjes së vendimit konstatojnë se ka parregullsi procedurale dhe/ose materiale në zbatimin e procedurës së azilit. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që vendimet e GJEDNJ-së të zbatohen si burim i legjislacionit të vendit.
- Ligji për Mbrojtjen Ndërkombëtare dhe të Përkohshme duhet të harmonizohet plotësisht me direktivat e BE-së. Transpozimi i pjesshëm i paragrafëve nga direktivat mund të çojë në shkelje serioze të të drejtave të azilkërkuesve dhe të refugjatëve.

●**Procedurat gjyqësore:**

- Gjykatat administrative duhet t'i përcaktojnë faktet kryesore për marrjen e vendimit të drejtë në shqyrtimet e planifikuara me gojë.
- Gjykatat janë të detyruara t'i respektojnë afatet e parashikuara me ligj.
- Gjatë marrjes së vendimeve, gjykatat vendase duhet t'i marrin parasysh pikëpamjet e shprehura në gjykimet e GJEDNJ-së me qëllim të mbrojtjes së plotë të të drejtave të personave me interes, kurse vendimet e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë të merren si një udhëzim specifik dhe arsyetim ligjor.

●**Kufizimi i lirisë së lëvizjes:**

- Kjo masë duhet të përdoret si mjet i fundit dhe i jashtëzakonshëm, dhe është e nevojshme të praktikohen alternativat e saj. Kufizimi i lirisë së lëvizjes nuk duhet të jetë arbitrar.
- Duhet të bëhet ndryshim i LMNP-së në mënyrë që të ketë mundësi për rishikim gjyqësor të aktvendimeve për kufizimin e lirisë së lëvizjes.

●**Mbajtja për arsye emigrimi:**

- Paraburgimi për arsye të emigrimit duhet të rishikohet nga një gjyqtar brenda 12 orëve nga paraburgimi.
- Fëmijët nuk duhet të paraburgosen për arsye emigrimi.
- Duhet të gjenden alternativa për mbajtjen që do të jenë ligjërisht të disponueshme dhe që do të zbatohen në praktikë.

●**Integrimi i hershëm:**

- Duhet të ketë një strategji dhe program për integrimin e hershëm të azilkërkuesve.
- Fëmijët refugjatë/emigrantë që janë të vendosur në qendrat e transitit duhet të përfshihen në arsimin formal si azilkërkues.
- Nuk duhet të ketë diskriminim të azilkërkuesve në ushtrimin e të drejtave të tyre në RMV. Urgjentisht duhet të gjendet zgjidhje që azilkërkuesit të jenë në gjendje të ushtrorjnë të drejtën e tyre për qasje në tregun e punës, duke qenë se kjo e drejtë aktualisht nuk u mundësohet.
- Nuk duhet të lejohet shkelja e të drejtës themelore të njeriut për jetë familjare dhe e drejta për t'u martuar.

●**Integrimi i personave nën mbrojtje ndërkombëtare:**

- Duhet gjetur një mënyrë për zgjidhje të qëndrueshme dhe përfundimtare të çështjes së refugjatëve kosovarë.
- Gjatë integrimit në RMV, organet kompetente nuk duhet të kërkojnë të marrin dokumente nga vendi i origjinës dhe kontakt me atë vend. Në rastet kur njerëzit duhet të marrin dokumente në vendin e tyre të origjinës, organet kompetente duhet të garantojnë se nuk do ta ndërpresin të drejtën e azilit të këtyre personave derisa të fitojnë shtetësinë e RMV-së. Ose, personi duhet të jetë në gjendje të japë një deklaratë që konfirmon se nuk është në gjendje t'i marrë këto dokumente nga vendi i tij/saj i origjinës, sepse ai/ajo ka të drejtë të njohur për azil në RMV.

- Lidhur me vërtetimin e vendbanimit në procedurën e pranimit në shtetësi, duhet të merret parasysh marrëveshja e qirasë, pa u vërtetuar në noter.
  - Në lidhje me mbrojtjen sociale, përfundimi i së drejtës për azil të një anëtari të familjes nuk duhet të ndikojë në mundësitë për mbrojtje sociale të anëtarëve të tjerë që janë ende persona me të drejtën e njohur të azilit në vend.
  - Qendrat për Punë Sociale dhe të gjitha organet e tjera kompetente duhet ta përdorin Ligjin për Marrjen dhe Shkëmbimin e Provave dhe të Dhënave sipas detyrës zyrtare.
- Kategoritë e cenueshme:**
- Të drejtat e fëmijëve dhe qasja në mekanizmat për mbrojtjen e fëmijëve duhet të jenë të disponueshme dhe të respektohen në mënyrë që të sigurohen interesat më të mira të fëmijës në përputhje me aktet dhe instrumentet ligjore të vendit dhe ato ndërkombëtare.
  - Fëmijët nuk duhet të përdoren si dëshmitarë në procedurat penale dhe për këtë arsye të mbahen.
  - Të drejtat e garantuara me Konventën e Stambollit duhet të zbatohen edhe në procedurën e azilit.
  - Orientimi seksual duhet të konsiderohet si bazë për persekutim në praktikë.